



VLERËSIMI I TRAJTIMIT TË RASTEVE TË DHUNIMIT NGA SISTEMI I DREJTËSISË NË KOSOVË

RAPORT I MONITORIMIT



Korrik 2022



European Union Rule of Law Mission in Kosovo

**VLERËSIMI I TRAJTIMIT TË RASTEVE
TË DHUNIMIT NGA SISTEMI
I DREJTËSISË NË KOSOVË**

Raport i monitorimit

Korrik 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	3
Parathënie	5
1. Hyrje	7
2. Metodologjia	9
3. Standardet dhe detyrimet përkatëse ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në lidhje me rastet e dhunimeve.....	10
3.1 Konventa e Këshillit të Evropës për Luftimin dhe Parandalimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)	10
3.2 Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW)	11
3.3 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)	11
3.4 Përmbledhje e detyrimeve	12
4. Analiza dhe gjetjet	14
4.1 Kriminalizimi: përputhshmëria e kornizës ligjore me kriteret e përcaktuara nga Konventa e Stambollit.....	14
4.1.1 Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në fuqi ndërmjet viteve 1977-2004.....	14
4.1.2 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) në fuqi ndërmjet viteve 2004 dhe 2012	14
4.1.3 Kodi Penal (KPK) në fuqi ndërmjet viteve 2013 dhe 2019	15
4.1.4 Kodi Penal (KPK aktual) në fuqi që nga viti 2019	15
4.1.5 Konkluzione	15
4.2 Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve	16
4.2.1 Kohëzgjatja e procedurave.....	18
4.2.2 Hetimi efektiv dhe përfundimi i rasteve.....	23
4.2.3 Ndëshkimi	25
5. Vërejtjet përmbyllëse.....	30
6. Rekomandime	31
6.1 Për Policinë e Kosovës	31
6.2 Për Prokurorinë.....	31
6.3 Për Gjykatat.....	31
6.4 Për Akademinë e Drejtësisë të Kosovës.....	32
6.5 Për Ministrinë e Drejtësisë	32

LISTA E SHKURTESAVE

CEDAW	Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
NJMR	Njësia për Monitorimin e Rasteve
CPCRK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
KEDNJ ose Konventa	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
DHBGJ	Dhuna në baza gjinore
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës kundër grave dhe Dhunës në Familje
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë



PARATHËNIE

Që nga dorëzimi i mandatit ekzekutiv të tij tek gjyqësori i Kosovës në qershor 2018, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka qenë i angazhuar në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e gjyqësorit të Kosovës. Duke u bazuar në monitorimin e thuktë të tërë zinxhirit të drejtësisë, Misioni deri më tani ka nxjerrë pesë raporte tematike. Ky raport special është i dedikuar për viktimat e dhunës seksuale, në veçanti të dhunimit, kërkesa e së cilave për drejtësi ende mbetet shumë shpesh pa përgjigje, e vonuar pa arsye apo edhe e mohuar. Raporti është i bazuar në monitorimin që Misioni i ka bërë trajtimit të rasteve të dhunës seksuale nga sistemi i drejtësisë në Kosovë.

Raport është pjesë e përpjekjeve të gjera të Misionit për mbështetjen e institucioneve të Kosovës për adresimin e dhunës kundër grave në përgjithësi dhe dhunimit si një prej manifestimeve më të rënda të saj. Ndonëse një vlerësim gjithëpërfshirës i trajtimit të të gjitha rasteve të dhunimit nuk është i mundur tani për shkak të vështirësive të hasura gjatë mbledhjes së të dhënave, të gjitha gjetjet e paraqitura në raport e tij janë tregues të mangësive sistematike të cilat kërkojnë vëmendjen urgjente të autoriteteve dhe institucioneve përkatëse të Kosovës.

Në një vendim historik, më 25 shtator 2020 Kuvendi i Kosovës në mënyrë unanime votoi në favor të amandamentimit të Kushtetutës për të mundësuar zbatimin e drejtpërdrejtë në Kosovë të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje. E njohur edhe si Konventa e Stambollit, ky instrument ligjor ndërkombëtar është konventa më gjithëpërfshirëse e të drejtave të njeriut mbi dhunën në baza gjinore, që përfshinë veprat e dhunës seksuale si dhunimi.

Vendimi i Kuvendit të Kosovës erdhi si rezultat i një fushate intensive të avokimit nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e të drejtave të grave, si dhe i ndërgjegjësimit të shtuar në mesin e politikbërësve për nevojën e trajtimit të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje në mënyrë më dinamike.

EULEX është i mandatuar t'i mbështesë institucionet e Kosovës për avancimin e zbatimit të kërkesave që dali nga Konventa e Stambollit. Gjersa ende ishte në postin e Kryetares së Kuvendit në shtator 2020, Presidentja Vjosa Osmani-Sadriu drejtoi votimin e suksesshëm të Konventës. Në letrën e saj drejtuar Përfaqësuesit të Lartë dhe Nënpresidentit të Komisionit Evropian Josep Borrell Fontelles më 14 qershor 2021, Presidentja e sapozgjedhur e Kosovës ftoi EULEX për të mbështetur zbatimin e Konventës së Stambollit.

Përgjatë vitit të kaluar ne kemi ofruar këtë mbështetje përmes shumë aktiviteteve, që nga mbajtja e fushatave të ndërgjegjësimit mbi temën e manipulimit mendor dhe lidhjen mes të drejtave pronësore dhe dhunës në familje, deri te dhënia e kontributit për hartimin e dokumenteve programatike, siç është Strategjia e re nacionale dhe plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna kundër grave, dhe udhëzuesit për themelimin e sistemeve të referimit për trajtimin e krimeve seksuale. Misioni ka hartuar një udhërrëfyes për krijimin e shërbimeve të mbështetjes së specializuar për viktimat e veprave të dhunës seksuale.¹ Misioni po ashtu është duke e mbështetur një grup punues të themeluar në mars 2022 nga Ministria e Drejtësisë për hartimin e Protokollit nacional për veprat e dhunës seksuale.²

Në fakt, puna e Misionit në fushën e dhunës gjinore daton edhe para amandamenteve kushtetuese të vitit 2020. Në vitin 2018, Misioni ndihmoi krijimin e një grupi punues që kishte si detyrë hartimin e udhëzuesve vendorë përkatës dhe të një protokollit për referimin e rasteve të dhunës seksuale. Megjithatë, atë kohë grupi punues nuk arriti të prodhonte një raport final.

Që nga viti 2018, Njësia e EULEX-it për Monitorimin e Rasteve (NJMR) bën monitorimin e veprave të dhunës seksuale, si formë e dhunës në baza gjinore, që nga momenti i denoncimit të tyre në polici

¹ Ky udhërrëfyes është dokument jopublik i cili është ndarë me Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e tjera përkatëse.

² Ministria e Drejtësisë e Kosovës, vendimi nr. 36/2022, 2022.

deri në gjykimin përfundimtar të tyre. NJMR-ja gjithashtu kryen analiza statistikore të rregullta të rasteve të dhunës seksuale dhe bën monitorimin e trendëve përkatëse. Në dhjetor 2021, EULEX-i e publikoi Raportin e tij të pestë Sistemik dhe Tematik për Drejtësinë, në të cilin u prezantuan disa gjetje preliminare për rastet e veprave të dhunës³.

Më tej, në shtator 2019, Misioni, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës (IML), e filloi fushatën “*Ma thuaj me kohë*”, me qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e garantimit të ruajtjes së provave biologjike pas veprave të dhunës seksuale. Pas nisjes së kësaj fushate, nga shtatori 2019 deri në shkurt 2020 janë mbajtur disa ligjërata nëpër shkolla fillore dhe të mesme nëpër Kosovës për t’i informuar fëmijët lidhur me këtë temë.

Rëndësia e krijimit të shërbimeve të specializuara për personat e mbijetuar të dhunës seksuale në Kosovë ishte gjithashtu në fokus të një konference të nivelit të lartë të organizuar nga EULEX-i dhe OJQ-ja Forumi për Leadership dhe Diplomaci më 2 dhjetor 2021 në Prishtinë. Më 3 dhjetor 2021, IML-ja, me mbështetjen e EULEX-it, e organizoi një punëtori me temën “*Dhuna seksuale: provat biologjike dhe rëndësia e tyre në procedurat penale*”, ku morën pjesë përfaqësues të Policisë së Kosovës, Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, prokurorive dhe gjykatave, për të diskutuar rëndësinë e raportimit me kohë të rasteve të dhunës seksuale nga viktimat dhe nevojën për bashkëpunim ndërinstytucional në mënyrë që autorët të sillen shpejt para drejtësisë.

Si Misioni i sundimit të ligjit i përkushtuar për mbështetjen e Kosovës për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të saj, EULEX-i është i gatshëm të vazhdojë t’iu ndihmojë institucioneve të Kosovës për përputhje të mëtejme me detyrimet që dalin nga Konventa e Stambollit, për shembull përmes krijimit të kushteve që viktimat të marrin dëmshpërblimin që iu takon si dhe për fuqizimin e një kulture që nuk toleron diskriminimin e grave.

Rekomandimet në fund të këtij raporti iu drejtohen akterëve institucionalë të ndryshëm në zinxhirin e drejtësisë, nga policia, prokuroritë dhe gjykatat. Ndërsa gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime për sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në familje, është e qartë se rastet e dhunës seksuale dhe rastet e dhunimit kanë ngelur pas, për shembull në aspektin e procedurave të standardizuara dhe të raportimit.

Në mesin e masave që duhet të ndërmerren sa më parë është themelimi i një protokollit të uniformuar për raportimin e rasteve të dhunës seksuale. Një protokoll i tillë veçse ekziston për rastet e dhunës në familje dhe duhet të zhvillohet urgjentisht për rastet e dhunimit dhe rastet e tjera të rënda të dhunës seksuale. Miratimi i një protokollit të tillë mund të përmirësojë edhe kohën dhe saktësinë e raportimeve fillestare policore dhe forenzike, ku është parë të ketë mangësi. Procedurat e ndryshme që aktualisht përdoren nga policia dhe prokuroritë të cilat e komplikojn më tej trajtimin e rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë, po ashtu duhet të kihet parasysh.

Shpresojmë që ky raport do të shërbejë për informim dhe kontribuim për procesin në vijim të zbatimit të Konventës së Stambollit jo vetëm në Kosovë por edhe nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe palët e tjera nënshkruese të Konventës, meqë shumë prej çështjeve të adresuara në raport janë universale për nga natyra. Ndërsa penalizimi i dhunës seksuale dhe i dhunimit arriti progres të jashtëzakonshëm në legjislacionin e Kosovës, zbatimi i dispozitave ligjore të së drejtës vendore ashtu edhe asaj ndërkombëtare, si Konventa e Stambollit, është ende i mangët.

Trajtimi i dhunës në baza gjinore është parim themelor i përafrimit me standardet dhe vlerat e Bashkimit Evropian. Dhe EULEX-i qëndron i gatshëm të vazhdojë të punojë ngushtë me të gjithë homologët përkatës në Kosovë për përmirësimin e trajtimit të rasteve të dhunimeve. Objektivi jona e përbashkët duhet të jetë një qëndrim më shumë i bazuar tek viktimat, ku qasja në drejtësi e grave, burrave, vajzave dhe djemve të ekspozuar ndaj dhunës seksuale dhe dhunimit është prioritet i përbashkët i të gjithë akterëve të zinxhirit të drejtësisë.

Lars-Gunnar Wigemark
Shefi i Misionit

3 Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, Raporti i Monitorimit të Drejtësisë, 2021, gjendet në: <https://www.eulek-kosovo.eu/eul/repositorydocs/RaportiEN162021.PDF> [qasur më 22 maj 2022].

1. HYRJJE

Dhuna seksuale, si fenomen mbarë botëror, vazhdon të jetë i padenoncuar mjaftueshëm në mënyrë dramatike dhe universale për shkak të frikës nga hakmarrja, mosbesimit në agjencitë e zbatimit të ligjit, stigmatizimit kulturor dhe shoqëror, si dhe traumave psikologjike të përjetuara nga viktimat. Në vitin 2002, Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizoi dhunën seksuale si *“çdo akt seksual ose përpjekje për të marrë një akt seksual, ose komente seksuale të padëshiruara apo akte për të trafikuar, që janë të drejtuara kundër seksualitetit të një personi duke përdorur detyrimin nga kushdo, pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, përfshirë në shtëpi dhe në punë”*⁴.

Përfshirës i një sërë veprash penale, si ngacmimin seksual, sulmin seksual dhe dhunimin, termi ‘dhunë seksuale’ përdoret për të shpjeguar dhunën në baza gjinore. Si e tillë është shkelje e të drejtave të njeriut, dhe një formë e diskriminimit. Në mënyrë specifike, dhuna seksuale është e rrënjësor në pabarazinë gjinore dhe marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe për rrjedhojë, megjithëse e përjetojnë edhe burrat dhe djemtë, ajo i prek kryesisht gratë dhe vajzat.

Në Raportin e Aktivitetit Përfundimtar të vitit 2008, Task Forca e Këshillit të Evropës për Luftimin e Dhunës kundër Grave, përfshirë Dhunën në Familje⁵ theksoi se vetëm një pjesë e rasteve të dhunës seksuale që denoncohen në polici ndiqen penalisht⁶. Arsyet për këtë janë të shumëfishta, dhe përfshijnë hetimet e pamjaftueshme policore, mungesën e procedurave sistematike të referimit që shpesh rezultojnë në pamundësinë e marrjes së provave biologjike dhe provave tjera vërtetuese, mungesa ose mbështetja joadekuate për viktimat në sistemin e drejtësisë penale, qëndrimet e pjesëtarëve të policisë dhe gjyqësorit dhe shumë të tjera. Raporti i Aktivitetit Përfundimtar theksoi gjithashtu se, edhe nëse fillohen procedurat penale, vetëm disa nga to çojnë deri te dënimet, kurse akoma më pak rezultojnë me dënime që janë proporcionale me natyrën e krimit.

Kosova nuk bën përjashtim nga këto trende dhe të dhënat e mbledhura nga EULEX-i tregojnë se, përderisa një numër i konsiderueshëm i rasteve të dhunës seksuale, veçanërisht ato që i prekin të miturit, janë denoncuar tek autoritetet përkatëse gjatë tri viteve të fundit, viktimave ju është ofruar dëmshpërblim efektiv në shumë pak raste. Për më tepër, duke e pasur parasysh mungesën e udhëzimeve dhe protokolleve të standardizuara në Kosovë, viktimat nuk mund të kenë qasje në zinxhirin e plotë të ndihmës së nevojshme, posaçërisht për shkak se nuk ekziston një procedurë e plotë për menaxhimin klinik dhe nuk ofrohet kujdes pasues.

Me anë të një amendamenti kushtetues të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 25 shtator 2020, institucionet e Kosovës u zotuan zyrtarisht për ta zbatuar Konventën e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)⁷. Kjo konventë përfshin detyrime specifike për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale duke përfshirë dhunimin, duke filluar nga aspekti i kriminalizimit deri te ai i mbrojtjes së viktimave.

4 Organizata Botërore e Shëndetësisë e OKB-së, Raporti botëror mbi dhunën dhe shëndetin, 2002, faqe 149, gjendet në: http://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/42495/9241545615_eng.pdf?sequence=1 [qasur më 24 maj 2022].

5 Task Forca e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës kundër grave, përfshirë dhunën në familje (EG-TFV), u krijua pas një vendimi të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Evropës të marrë në vitin 2005. Task Forca, e cila përbëhet nga tetë ekspertë ndërkombëtarë, ndër të tjera u mandatua: të vlerësojnë efektivitetin e masave të miratuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave; të bëjnë propozime për rishikimin e këtyre masave ose miratimin e masave të reja dhe; të zhvillojë një metodë për të ndihmuar shtetet anëtare të miratojnë politika praktike për të luftuar dhunën kundër grave.

6 Këshilli i Evropës, aktiviteti i raportit përfundimtar, Task Forca e Këshillit të Evropës për luftimin e dhunës kundër grave, përfshirë dhunën në familje, 2008, gjendet në https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/Source/Final_Activity_Report.pdf [qasur më 22 maj 2022].

7 Këshilli i Evropës, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, 2014, [më tej në tekst Konventa e Stambollit], gjendet në <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/text-of-the-convention> [qasur më 24 maj 2022].

Ky raport synon të ofrojë një vlerësim preliminar të gjendjes në lidhje me trajtimin e rasteve të cilësuar si dhunime në Kosovë, në prizmin e standardeve ndërkombëtare të përcaktuara nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), si dhe nga instrumentet e tjera përkatëse ndërkombëtare që në Kosovë janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke përfshirë Konventën e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Pas shpjegimit të metodologjisë së përdorur (kapitulli 2), raporti jep një përmbledhje të standardeve përkatëse të të drejtave të njeriut të aplikueshme në Kosovë (kapitulli 3). Raporti vazhdon me një vlerësim të kornizës ligjore si dhe gjetjeve të Misionit në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunimit (kapitulli 4) dhe përfundon me vërejtje përmbyllëse (kapitulli 5) dhe një listë të rekomandimeve specifike për autoritetet relevante dhe kompetente të Kosovës (kapitulli 6).

2. METODOLOGJIA

Misioni i ka shqyrtuar rastet e klasifikuara si dhunim sipas nenit 227 të Kodit Penal aktual të Kosovës⁸, duke i përdorur dy nivele vlerësimi: i pari lidhur me mbledhjen e të dhënave statistikore, kurse i dyti i bazuar në analizën e rasteve të përzgjedhura individuale⁹. Rastet e përzgjedhura për vlerësim në nivelin e dytë përfshinin tre fazat e sistemit të drejtësisë: (1) fazën policore, (2) fazën e ndjekjes penale dhe (3) fazën gjyqësore.

Për vlerësimin në nivel të parë, të dhënat statistikore i referohen periudhës ndërmjet viteve 2019 dhe 2021, si dhe bazohen në shifrat e marra nga Policia e Kosovës (PK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), prokuroritë rajonale, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe gjykatat themelore. Statistikat përfshijnë numrin e rasteve të denoncuar në PK, numrin e rasteve të referuara në prokurori, numrin e rasteve të mbyllura, numrin e aktakuzave të ngritura dhe numrin e rasteve të përfunduara me aktgjykim në shkallë të parë. Gjithashtu, ky Mision ka marrë të dhëna edhe nga IML-ja për rastet e dhunimit që janë dërguar për ekzaminim forenzik.

Mision ka hasur disa vështirësi për qasje në të dhënat statistikore të konsoliduara. Prandaj, për të garantuar një analizë më gjithëpërfshirëse të dhënave në dispozicion, për vlerësimin në nivelin e dytë, ky Mision kërkoi informacion për raste specifike nga të tre fazat e sistemit të drejtësisë.

Për fazën policore, ky Mision ka marrë informacione për rreth 153 raste të cilësuar si dhunime nga PK-ja për periudhën nga gushti 2019 deri në dhjetor 2021. Këto raste janë përmbledhur dhe renditur gjeografikisht sipas rajoneve dhe pastaj janë analizuar.

Për fazën e ndjekjes penale, janë kërkuar të dhëna nga prokuroritë themelore dhe KPK lidhur me 153 rastet e njëjta të identifikuar nga PK-ja¹⁰. Informatat janë dhënë vetëm për 129 raste. Duke u bazuar në këtë informacion, Misioni bëri vlerësim se sa prej këtyre rasteve vazhduan procedurën për të kaluar në gjykatat themelore përkatëse.

Për fazën e tretë, janë kërkuar informata nga gjykatat e përzgjedhura dhe KGJK-ja lidhur me aktgjykimet e caktuara të nxjerra për rastet e dhunimit për ta analizuar arsyetimin e detajuar të dënimeve. Ky Mision i pranoi gjithsej 36 aktgjykime. Në 21 prej tyre, veprat penale kishin ndodhur para vitit 2019, kurse në 15 aktgjykimet tjera, veprat penale kishin ndodhur në periudhën ndërmjet viteve 2019-2021.

Të dhënat e pranuar u plotësuan me informatat e marra nga takimet me prokurorët dhe gjyqtarët, monitorimit të seancave gjyqësore për rastet e përzgjedhura dhe analizimit të aktakuzave dhe aktgjykimeve që janë publike. Informata shtesë u mblodhën nga komunikatat për shtyp, takimet me përfaqësues të shoqërisë civile, bashkëpunimit me këshilltarët gjinorë nga organizata të tjera vendase dhe ndërkombëtare, si dhe nga pjesëmarrja në seminare ku u trajtuan rastet e dhunës seksuale.

Ndryshe nga mbledhja e të dhënave për veprën penale të dhunës në familje, marrja e të dhënave të qëndrueshme dhe të konsoliduara për veprën penale të dhunimit rezultoi problematike. Në disa rajone, institucionet kanë dhënë informacionin pa hezitim, ndërsa në disa rajone tjera pati nevojë që t'u dërgoheshin disa herë kërkesa dhe përkujtesa. Për më tepër, disa kërkesa nuk kanë marrë përgjigje fare. Nga përgjigjet që përfshinin vetëm përgjigje të formuluar pjesërisht, rezultoi se nuk ekziston një sistem digjital i integruar për rastet e dhunimeve nga i cili mund të gjenerohej ky informacion, për shkak të mungesës së procedurave standarde të operimit që e rregullojnë mbledhjen dhe ruajtjen e informatave për këto vepra penale.

8 Kodi Penal i Kosovës, Kodi Nr. 06/L-074, 2019, faqe 89-91, gjendet në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf> [qasur më 22 maj 2022].

9 Misioni vendosi të fokusohet në veprën penale specifike të dhunimit dhe jo në forma të tjera të dhunës seksuale, për të shtrirë më mirë trajtimin e këtij krimi.

10 Fokusi i Misionit ishte të shqyrtonte rastet e klasifikuara si dhunime sipas nenit 227, megjithatë, siç u shpjegua më pas në Kapitullin 4.2.1.1, KPK prezantoi statistikat e përgjithshme rreth Kapitullit XX të KPK aktual, Kapitullit XX të KPK (të mëparshëm) dhe Kapitullit XIX të KPPK-së. KPPK. Mungesa e qasjes në të dhënat e zbërthyer për veprën penale të dhunimit është identifikuar si mangësi e mbledhjes së të dhënave të KPK dhe si temë e rekomandimeve nga Misioni në kapitullin e titulluar "Rekomandime".

3. STANDARDET DHE DETYRIMET PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LIDHJE ME RASTET E DHUNIMEVE

Në nenin 22, Kushtetuta e Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të garantuara me nëntë instrumente ndërkombëtare të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe në rast konfliktit të së drejtës vendore dhe asaj ndërkombëtare, ato kanë përparësi ndaj çdo ligji vendor apo akti tjetër të institucioneve publike¹¹. Disa nga instrumentet e renditura në nenin 22 e trajtojnë dhunën seksuale kundër grave dhe vajzave, ku përfshihen: Konventa e Stambollit, Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër grave (CEDAW) dhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)¹². Për më tepër, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara në të duhet të interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Së fundi, vendimet e Komitetit CEDAW¹³, si dhe Raporteve Bazë të Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës kundër grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO) shërbejnë si mjete të rëndësishme për institucionet vendase për transpozimin e standardeve ndërkombëtare në praktikën e tyre¹⁴.

3.1 Konventa e Këshillit të Evropës për Luftimin dhe Parandalimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

Konventa e Stambollit ka dy dispozita që lidhen me dhunën seksuale, duke përfshirë dhunimin, të cilat janë të përfshira në nenin 25 dhe nenin 36.

Neni 36 e përcakton veprën penale të dhunës seksuale¹⁵ ndërsa neni 25 e trajton mbështetjen për viktimat e dhunës seksuale¹⁶ dhe kërkon që autoritetet të marrin masat e nevojshme për të ofruar mbështetje të specializuar duke ngritur qendra referimi për situatat e krizave të dhunimit ose dhunës seksuale që janë lehtësisht të qasshme.

Për më tepër, në këtë Konventë ekziston një numër i dispozitave shitesë të cilat duhen përmendur në këtë kontekst, konkretisht: Neni 5 mbi detyrimet shtetërore dhe kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar dëmshpërblim për aktet e dhunës të kryera nga akterë jo shtetërorë¹⁷, Neni 11 që kërkon mbledhjen e të dhënave përkatëse statistikore të zberthyer¹⁸, Neni 49 i cili i përshkruan detyrimet e përgjithshme lidhur me hetimin, ndjekjen penale, ligjin procedural dhe masat mbrojtëse¹⁹, dhe Neni 55 që rregullon procedurat *ex-parte* dhe *ex-officio*²⁰.

11 Kushtetuta e Kosovës, shtator 2020, faqe 6.

12 Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e ndryshuar nga Protokollet Nr. 11 dhe 14, 1950, gjendet në: https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf [qasur më 22 maj 2022].

13 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër grave është organi i ekspertëve të pavarur që monitoron zbatimin e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave.

14 Grupi i ekspertëve mbi veprimin kundër dhunës kundër grave dhe dhunës në familje është një nga dy shtyllat (tjetra është Komiteti i palëve) që monitoron zbatimin e Konventës së Stambollit nga shtetet palë.

15 Konventa e Stambollit, neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë dhunimi.

16 Konventa e Stambollit, neni 25 – Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale.

17 Konventa e Stambollit, neni 5 – Detyrimet shtetërore dhe kujdesi i duhur.

18 Konventa e Stambollit, neni 11 – Mbledhja e të dhënave dhe hulumtimet.

19 Konventa e Stambollit, neni 49 – Detyrimet e përgjithshme.

20 Konventa e Stambollit, neni 55 – Procedurat ex parte dhe ex officio.

3.2 Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW)

Megjithëse CEDAW nuk e trajton në mënyrë specifike çështjen e dhunës seksuale, në Rekomandimin e tij të Përgjithshëm 19 mbi Dhunën kundër Grave të miratuar në 1992, Komiteti i CEDAW deklaroi se për t'i eliminuar të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunimin, shtetet duhet të ndërmarrin “*masa pozitive*”²¹. Ai rekomandoi që autoritetet “*duhet të sigurojnë që ligjet kundër dhunës dhe abuzimit në familje, dhunimit, sulmit seksual dhe dhunës tjetër në baza gjinore u japin mbrojtjen e duhur të gjitha grave dhe e respektojnë integritetin dhe dinjitetin e tyre*”²². Ai theksoi më tej se, duhet të ofrohen shërbimet e duhura mbrojtëse dhe mbështetëse për viktimat, duke e theksuar rëndësinë e trajnimit të posaçëm me ndjeshmëri gjinore të zyrtarëve gjyqësorë dhe atyre të zbatimit të ligjit dhe zyrtarëve të tjerë publikë. Ai, gjithashtu nënvizoi se shërbimet për viktimat (përfshirë refugjatët) e dhunës në familje, dhunimit, sulmit seksual dhe formave tjera të dhunës në baza gjinore, si rehabilitimi dhe këshillimi, duhet të vihen në dispozicion.

Rekomandimi i Përgjithshëm 33 i CEDAW për Qasjen e Grave në Drejtësi²³ dhe Rekomandimi i Përgjithshëm 35 për Dhunën në Baza Gjinore²⁴ janë gjithashtu të rëndësishëm për qëllimet e këtij raporti, pasi i pari i referohet natyrës së rregullave të provave, kurse i dyti ka të bëjë me detyrimet e shtetit në ndjekjen penale dhe dëmshpërblimet në rastet e dhunës seksuale.

3.3 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

KEDNJ është instrument neutral ndaj gjinisë dhe nuk e trajton çështjen e dhunës seksuale në mënyrë eksplicite. Megjithatë, GJEDNJ-ja ka prodhuar jurisprudencë për të drejtat e grave, duke përfshirë dhunën kundër grave, dhe gjithashtu ka vendosur disa standarde të rëndësishme për qasjen e barabartë të grave në drejtësi.

Për shembull, në rastin historik të *MC kundër Bullgarisë*²⁵, ankuesja (që ishte 14 vjeçare në kohën e dhunimit të pretenduar) pohoi se ligji bullgar nuk ofronte mbrojtje efektive kundër dhunimit dhe abuzimit seksual, pasi vetëm rastet në të cilat viktimat kishin rezistuar në mënyrë aktive u ndoqën penalisht dhe se autoritetet nuk i kishin hetuar siç duhet pretendimet e saj.

Në vendimin e saj, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 (ndalimi i torturës) dhe nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës duke e pranuar se kishte të meta jo vetëm në hetimin e çështjes, por edhe në ligj. Gjykata e theksoi mungesën e pëlqimit si element thelbësor në përcaktimin e dhunimit dhe abuzimit seksual dhe se si viktimat e abuzimit seksual, veçanërisht vajzat e reja, shpesh nuk arritën të kundërshtonin për arsye psikologjike ose nga frika e dhunës së

21 Komiteti i OKB-së për eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW nr. 19: Dhuna kundër grave, 1992, në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_3731_E.pdf [e qasur më 23 maj 2022].

22 Po aty para 24.b

23 Komiteti i OKB-së për eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW nr. 33: Qasja e grave në drejtësi, 2015, gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_33_7767_E.pdf [qasur më 23 maj 2022].

24 Komiteti i OKB-së për eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35: Mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, përditësimi i rekomandimit të përgjithshëm nr. 19, 2017, në gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_35_8267_E.pdf [qasur më 23 maj 2022].

25 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *MC kundër Bullgarisë*, nr. 39272/98, 2003, gjendet në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-61521> [qasur më 23 maj 2022].

mëtejme. Ndalimi i torturës u përshkrua si: “*detyrim pozitiv për të miratuar dispozita të ligjit penal që e ndëshkojnë në mënyrë efektive [krimin e rëndë] dhe për t’i zbatuar ato në praktikë përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive*”²⁶. I njëjti vendim shton se “[...] gjykata konsideron se shtetet kanë një detyrim pozitiv të natyrshëm në nenet 3 dhe 8 të Konventës për të miratuar dispozita të ligjit penal që ndëshkojnë në mënyrë efektive dhunimin, si dhe për t’i zbatuar ato në praktikë përmes hetimit dhe ndjekjes penale efektive”²⁷.

Për më tepër, GJEDNJ, në jurisprudencën e saj, i referohet gjithnjë e më shumë Konventës së Stambollit dhe raporteve bazë të komisionit GREVIO, duke e theksuar kështu rëndësinë e kësaj Konvente në formësimin e standardeve ligjore në rastet e dhunës kundër grave.

3.4 Përmbledhje e detyrimeve

Në prizmin e standardeve të drejtave të njeriut dhe jurisprudencës së përmendur më sipër, detyrimet e institucioneve të Kosovës gjatë trajtimit të rasteve të dhunimit mund të grupohen në katër fusha kryesore:

- a) Kriminalizimi;
 - b) Mbledhja e të dhënave dhe hulumtimi;
 - c) Kujdesi i duhur për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar dëmshpërblim për aktet e dhunës të mbuluara nga fushëveprimi i kësaj Konvente që kryhen nga aktorë jo shtetërorë ;
 - d) Ofrimi i shërbimeve të specializuara.
- a) Sipas nenit 36 të Konventës së Stambollit, Kosovës i kërkohet që të kriminalizoj të gjitha format e akteve seksuale pa pëlqim, duke përfshirë dhunimin dhe më konkretisht të kriminalizoj tre lloje të sjelljeve të qëllimshme: “*a) përfshirja në penetrim vaginal, anal ose oral pa pëlqim, të natyrës seksuale të trupit të një personi tjetër me ndonjë pjesë trupore ose send; b) përfshirja në akte të tjera të natyrës seksuale pa pëlqim me një person; c) bërja e një personi tjetër që të përfshihet në akte të natyrës seksuale pa pëlqim me një person të tretë*”. Kjo dispozitë specifikon se “*pëlqimi*” duhet të jepet vullnetarisht në bazë të vullnetit të lirë dhe se aktet e kryera ndaj ish-bashkëshortëve ose partnerëve duhet të kriminalizohen gjithashtu²⁸. Elementi kryesor i përkufizimit të kësaj Konvente për dhunën seksuale si vepër penale është mungesa e pëlqimit të dhënë vullnetarisht nga viktimat, duke mos u kërkuar përdorimi i forcës ose kërcënimit nga kryerësi dhe prova e rezistencës nga viktimat.
- b) Me qëllim të zbatimit të Konventës së Stambollit, institucionet e Kosovës pritet të mbledhin të dhëna statistikore të zberthyera në intervale të rregullta dhe të mbështesin hulumtimin për të gjitha format e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, duke përfshirë dhunën seksuale (neni 11). Siç theksohet në Raportin Shpjegues për Konventën e Stambollit, mbledhja sistematike dhe adekuate e të dhënave është një komponent thelbësor i politikë bërjes efektive dhe mund të inkurajojë denoncimin nga viktimat dhe dëshmitarët. Të dhënat përkatëse statistikore duhet të përfshijnë informatat e dhëna nga institucionet e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit dhe shtrihen edhe në informatat e ofruara nga institucionet e kujdesit shëndetësor, të mirëqenies sociale dhe OJQ-të²⁹.

26 Po aty, paragrafët 148-153.

27 Po aty.

28 Konventa e Stambollit, Neni 36 – Dhuna seksuale, përfshirë dhunimi.

29 Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, f. 14. Më tej në tekst Raporti shpjegues për Konventën e Stambollit , gjendet në: <https://rm.coe.int/ic-and-explanatory-report/16808d24c6> [i qasur më 24 maj 2022].

- c) Konventa e Stambollit (në veçanti neni 11) dhe Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 19 i Komitetit të CEDAW, përmban parimin e kujdesit të duhur për institucionet përkatëse të cilat e kanë mandatin për ta organizuar reagimin e tyre ndaj akteve të dhunës seksuale që mundëson hetimin dhe ndëshkimin e tyre. Tutje, hetimet dhe procedurat gjyqësore duhet të kryhen *“pa vonesa të panevojshme”* (neni 49 i Konventës së Stambollit). Hetimet dhe ndjekjet penale duhet të kryhen në mënyrë efektive gjithashtu; kjo do të thotë, për shembull, se duhet të vërtetohen faktet përkatëse, të intervistohen dëshmitarët në dispozicion dhe të kryhen ekzaminimet mjeko-ligjore³⁰. Sipas kësaj Konvente, Kosovës i kërkohet gjithashtu që të sigurojë që hetimet ose ndjekja penale e veprave të dhunës seksuale *“nuk do të varen tërësisht nga denoncimi apo ankesa e parashtruar nga viktimat...dhe se procedurat mund të vazhdojnë edhe nëse viktimat tërhiqet nga deklaratat apo ankesa e tij ose saj”*³¹.
- d) Duke e pohuar traumën e rëndë që përcjell dhunën seksuale, përfshirë dhunimin, Konventa e Stambollit përcakton se mbështetja për viktimat, duke përfshirë kujdesin e menjëhershëm mjekësor, mbështetjen për traumën, këshillimin dhe ekzaminimin mjeko-ligjor, duhet të ofrohen nga personel i trajnuar dhe i specializuar.

30 Raport shpjegues për Konventën e Stambollit, Neni 49 – Detyrimet e Përgjithshme, f. 43.

31 Konventa e Stambollit, Neni 55 – Procedura *ex parte* dhe *ex officio*.

4. ANALIZA DHE GJETJET

4.1 Kriminalizimi: përputhshmëria e kornizës ligjore me kriteret e përcaktuara nga Konventa e Stambollit

Në Kosovë, korniza e përgjithshme legislative që e rregullon dhunimin dhe marrëdhëniet seksuale me të mitur ka pësuar ndryshime të rëndësishme në dekadat e fundit. Dënimet janë rritur, fushëveprimi i veprës është përcaktuar në mënyrë më të qartë dhe është zgjeruar dukshëm. Kjo pjesë ofron një pasqyrë të asaj se si ka ndryshuar kriminalizimi i veprës penale të dhunimit në Kosovë bazuar në kode të ndryshme penale.

4.1.1 Ligji penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në fuqi ndërmjet viteve 1977-2004

Sipas këtij ligji, dhunimi ishte i inkriminuar në nenin 74, i cili parashihte dënimin me burgim nga një deri në 10 vjet për këdo që e detyronte “...në marrëdhënie seksuale një person femër me të cilën kryerësi nuk jeton në bashkësi martesore”³².

Neni 77 inkriminonte si vepër më vete “Marrëdhëniet seksuale ose shturje të panatyrshme me një person nën moshën 14 vjeç” dhe parashihte se kushdo që kryente marrëdhënie seksuale ose “shturje të panatyrshme” ndaj një personi nën moshën 14 vjeç, do të dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Në rast se vepra është kryer me përdorim të forcës, kundër një ‘personi të pafuqishëm’ ose me kërcënim të drejtpërdrejtë, autori mund të dënohej me të paktën tre vjet burgim. Në rast të lëndimeve të rënda trupore, vdekjes së të miturit, ose nëse vepra është kryer nga disa persona, ose në një mënyrë të veçantë mizore ose poshtëruese ose në ndonjë rast tjetër veçanërisht të rëndë, dënimi i paraparë ishte së paku pesë vjet burgim.

4.1.2 Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) në fuqi ndërmjet viteve 2004 dhe 2012

Nëpërmjet nenit 193 të këtij kodi, vepra penale e dhunimit u zgjerua duke e zëvendësuar shprehjen “person femër” me “person tjetër” dhe u hoq kushti që kryerësi “të mos jetojë në bashkësi martesore”³³. Si rezultat i kësaj, çdo person, pavarësisht nga gjinia e tij/saj, mund të jetë viktimë e dhunimit, ndërsa dhunimi brenda një bashkimi martesor u kriminalizua gjithashtu. Sa i përket dënimit, neni 193, paragrafi 1 i KPPK parashihte dënime me burgim prej dy deri në 10 vjet³⁴. Neni 198 e rregullon në mënyrë specifike abuzimin seksual ndaj personave nën moshën 16 vjeç; ai parashihte se, kur një akt seksual ka ndodhur ndërmjet dy personave që kishin mbushur moshën 14 vjeç dhe ku diferenca e moshës ishte më shumë se dy vjet, por ku nuk kishte dallim të qartë në nivelin e pjekurisë, ky akt nuk përbënte vepër penale. KPPK gjithashtu në mënyrë eksplicite e përcaktoi, në nenin 192, nocionin e “pëlqimit”, duke vënë në dukje se marrëveshja vullnetare e një personi nën moshën 16 vjeç për një akt seksual nuk konsiderohej e vlefshme.

32 Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Nr. 011-25/77, 1977.

33 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, UNMIK/REG/2003/25, 2003, [në tekstin e mëtejshëm KPPK], gjendet në: http://www.icsl.de/dokumente/criminal_code_of_kosovo.pdf [qasur më 23 maj 2022].

34 Kur vepra kryhet me përdorim të forcës, “kanosja të rrezikut të afërt, duke e shfrytëzuar situatën”, dënimi rritet në “tre deri në 10 vjet burgim” sipas paragrafit 2. Autori dënohet me “pesë deri në 15 vjet burgim”. kur krimi paraprihet, shoqërohet ose pasohet me torturë ose trajtim çnjerëzor, lëndime të rënda trupore, përdorim të armës, intoksikim, kryer nga më shumë se një person, ndaj një viktime jashtëzakonisht të cenueshme, ‘nga një anëtar i familjes/ marrëdhënie në bashkësisë familjare dhe viktimë është ndërmjet 16 dhe 18 vjeç. Nëse vepra rezulton me ‘vdekjen e viktimës’, dënimi i paraparë ishte me ‘së paku 10 vjet burgim deri në burgim të përjetshëm’.

4.1.3 Kodi Penal (KPK) në fuqi ndërmjet viteve 2013 dhe 2019

Sipas këtij kodi, vepra e dhunimit ishte e inkriminuar në nenin 230, ndërsa “abuzimi seksual i personave nën moshën 16 vjeçare” ishte inkriminuar me anë të një neni tjetër (neni 235), siç ishte bërë në KPPK³⁵.

Neni 230 i paraqiti të njëjtat dispozita si ato të renditura në KPPK, megjithatë, ai gjithashtu e zgjeroi përkufizimin e aktit të dhunimit duke vënë në dukje se ai përfshinte kërcënimin “për të zbuluar një fakt që do të dëmtonte rëndë nderin ose reputacionin e atij personi ose të ndonjë personi të lidhur ngushtë me atë person”. Në lidhje me nocionin e pëlqimit, KPK përmbante të njëjtat dispozita si në kodin e mëparshëm³⁶.

Krahasuar me KPPK, neni 235 përfshin gjithashtu disa vepra penale kundër integritetit seksual të personave nën moshën 16 vjeçare, (pra, dhunim, sulm seksual dhe degradim i integritetit seksual dhe shqiptonte dënime më të ashpra për kryerësit përkatës.

4.1.4 Kodi Penal (KPK aktual) në fuqi që nga viti 2019

Kodi Penal aktual ka hyrë në fuqi në prill 2019³⁷. Sipas nenit 227 të tij, vepra penale e dhunimit është përkufizuar në mënyrë të ngjashme dhe parasheh dënime të ngjashme si në KPPK dhe KPK të mëparshëm. Megjithatë, në krahasim me Kodet e mëparshme, KPK-ja aktuale nuk përmban më një nen të veçantë që e rregullon veprën penale të abuzimit seksual të personave nën moshën 16 vjeç, por e përfshinë atë në kuadër të nenit 227 si dhunim.

Paragrafi 6 parasheh pesë (5) deri në njëzet (20) vite burgim kur dhunimi kryhet ndaj një personi nën moshën 16 vjeç, ndërsa paragrafi 7 parasheh dënimin me së paku 10 vjet burgim kur vepra kryhet ndaj personit nën 14 vjet.

Sipas nenit 225, nën paragrafi 1.1 i KPK-së, shprehja pëlqim përkufizohet si marrëveshje vullnetare e një personi që e ka mbushur moshën 16 vjeç për t’u përfshirë në një akt seksual. Nën paragrafi 1.2 i të njëjtit nen shton se marrëveshja vullnetare për kryerjen e aktit seksual e dy personave të cilët kanë mbushur moshën 14 vjeçare dhe kur diferenca mes moshës e tyre nuk i kalon dy vjet konsiderohet gjithashtu si pëlqim.

4.1.5 Konkluzione

Kriminalizimi i veprës penale të dhunimit në Kosovë ka bërë përparim të dukshëm në përafrimin me standardet ndërkombëtare të përmendura në kapitullin tre, duke krijuar kështu një kornizë ligjore më të fortë për ndjekjen penale të këtij lloji të dhunës seksuale. Mungesa e pëlqimit të viktimës është elementi përbërës i veprës penale, në përputhje me nenin 36 të Konventës së Stambollit dhe me Rekomandimin e Përgjithshëm 35 të CEDAW³⁸, dhe me nenin 227 të KPK aktual. KPK-ja aktuale tani parasheh ndëshkime më të larta për të gjitha llojet e dhunimeve të kryera në një marrëdhënie familjare, ndërsa KPK-ja i konsideronte si rrethana rënduese vetëm rastet kur kryerësi kishte një marrëdhënie familjare me një person ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeç³⁹. Për këtë qëllim, përkufizimi

35 Kodi Penal i Kosovës, 04/L-082, 2012, [në tekstin e mëtejme KPK], gjendet në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf> [qasur më 23 maj 2022].

36 Po aty, neni 228.

37 Kodi Penal i Kosovës, 06/L-074, 2018, [në tekstin e mëtejme KPK aktual], gjendet në: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf> [qasur më 23 maj 2022].

38 Komiteti i OKB-së për eliminimin e diskriminimit kundër grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35: Mbi dhunën me bazë gjinore kundër grave, përditësimi i rekomandimit të përgjithshëm nr. 19, 2017, paragrafi 33, gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_35_8267_E.pdf [qasur më 23 maj 2022].


39 KPK, neni 230, nën paragrafi 4.9.

aktual në KPK i marrëdhënies familjare është gjithashtu në përputhje me nenin 36 paragrafi 3 të Konventës së Stambollit, pasi i përfshin bashkëshortët aktualë dhe ish-bashkëshortët⁴⁰.

Vlen gjithashtu të theksohet se KPK-ja aktuale në nenin 225 nën paragrafin 1.2 të tij përmban një dispozitë për aktivitetin seksual ndërmjet bashkëmoshatarëve, ku e thekson se marrëdhëniet seksuale ndërmjet “*dy personave që kanë mbushur moshën katërmëdhjetë (14) vjeç dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk i kalon dy (2) vjet*” nuk do të penalizohet si vepër penale e dhunimit. Si rezultat, një çështje e mundshme për shqetësim është së, aktiviteti seksual me pëlqim mes, për shembull, një personi 14 vjeçar dhe një personi 17 vjeçar, automatikisht cilësohet si rast i dhunimit, ndërsa neni 198 i KPPK parashihte se kur një akt seksual ka ndodhur ndërmjet dy personave që kishin mbushur moshën 14 vjeç dhe dallimi në moshë ishte më shumë se dy vjet, por nuk kishte dallim të qartë në nivelin e pjekurisë, ajo vepër në vetvete nuk përbënte vepër penale.

4.2 Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve

Në bazë të dhënave statistikore të marra nga EULEX-i, nga viti 2019 deri në vitin 2021 në PK janë denoncuar 228 raste të cilësuar si dhunim, konkretisht 57 në vitin 2019, 64 në vitin 2020 dhe 107 në vitin 2021. Kjo paraqet një trend në rritje, me rritjen e përqindjes vjetore të rasteve të denoncuar si në vijim: nga 2019 në 2020 rritja ishte 12%, nga 2020 në 2021 rritja ishte 67% pra një rritje e përgjithshme prej 87% nga 2019 në 2021.



Megjithatë, të dhënat në dispozicion nuk mundësojnë një vlerësim të ndikimit të mundshëm që mund të ketë pasur pandemia COVID-19 (dhe rregulloret e izolimit që detyruan bashkëjetesën e njerëzve) në një rritje kaq të mprehtë tek numri i rasteve të denoncuar të dhunimit në vitin 2021. Më tej, është e paqartë nëse dispozitat ligjore të përmendura më sipër lidhur me aktivitetet seksuale ndërmjet personave nën moshën 18 vjeçe (përkatesisht neni 225, nën paragrafi 1.2 i KPK-së aktuale) mund ta kenë shkaktuar rritjen e madhe të rasteve të denoncuar. Në mënyrë të ngjashme, nuk mund të arrihet në konkluzion të qartë nëse ndryshimi të ndërgjegjësimi dhe sjellja denoncuese mund ta ketë shkaktuar këtë rritje.

Sa i përket shpërndarjes rajonale të rasteve, të dhënat tregojnë se nga viti 2019 deri në vitin 2021, mesatarisht 35% e të gjitha rasteve janë denoncuar në Prishtinë.


Për shpërndarjen e plotë rajonale të rasteve në lidhje me secilin prej viteve të analizuar dhe për qytetet për të cilat ishte në dispozicion informacioni përkatës, ju lutemi shikoni grafikët e mëposhtëm⁴¹.

⁴⁰ KPK aktual, neni 113, paragrafi 25.

⁴¹ Shpërndarja e 57 rasteve sipas rajoneve në vitin 2019: Ferizaj katër raste (7%), Drejtoria e Përgjithshme një rast (2%), Gjakovë nëntë raste (16%), Gjiilan tetë raste (14%), Mitrovica Veriore një rast (2%), Pejë pesë raste (9%), Prishtinë 24


SHPËRNDARJA RAJONALE E RASTEVE NË VITIN 2019

- Ferizaj
- Drejtoria e Përgjithshme
- Gjakovë
- Gjilan
- Mitrovica Veriore
- Pejë
- Prishtinë
- Prizren




SHPËRNDARJA RAJONALE E RASTEVE NË VITIN 2020

- Ferizaj
- Drejtoria e Përgjithshme
- Gjakovë
- Gjilan
- Mitrovica Veriore
- Pejë
- Prishtinë
- Prizren



SHPËRNDARJA RAJONALE E RASTEVE NË VITIN 2021


- Ferizaj
- Drejtoria e Përgjithshme
- Gjakovë
- Gjilan
- Mitrovica Jugore
- Pejë
- Prishtinë
- Prizren
- Mitrovica Veriore



raste (42%), Prizren pesë raste (9%); Shpërndarja e 64 rasteve sipas rajoneve në vitin 2020: Ferizaj gjashtë raste (9%), Drejtoria e Përgjithshme një rast (1,5%), Gjakovë 13 raste (20%), Gjilan nëntë raste (14%), Mitrovica Jugore gjashtë raste (9%), Pejë pesë raste (8%), Prishtinë 21 raste (33%), Prizren tri raste (5%); Shpërndarja e 107 rasteve sipas rajoneve në vitin 2021: Ferizaj nëntë raste (8%), Drejtoria e Përgjithshme pesë raste (5%), Gjakovë pesë raste (5%), Gjilan 22 raste (21%), Mitrovicë Veriore një rast (1%), Mitrovica Jugore 14 raste (13%), Pejë dy raste (2%), Prishtinë 33 raste (31%), Prizren 16 raste (15%).

Një trend tjetër i vërejtur është se shumica e viktimave janë vajza të mitura (në 85% të rasteve), siç dëshmohet edhe nga të dhënat e marra nga IML-ja, ku të gjithë kryesit janë meshkuj. Gjegjesisht, sipas këtyre të dhënave, në periudhën 2019-2021 janë kryer gjithsej 245 ekzaminime klinike të viktimave të mundshme (217 femra dhe 28 meshkuj); 47 në 2019, respektivisht 92 në 2020 dhe 106 në 2021.

NUMRI I EKZAMINIMEVE KLINIKE MES 2019 DHE 2021



4.2.1 Kohëzgjatja e procedurave

4.2.1.1 Të dhëna statistikore

Siç u theksua më sipër, gjithsej 228 raste të cilësuara si dhunime janë denoncuar në PK në vitet 2019, 2020 dhe 2021, përkatësisht 57 në 2019, 64 në 2020 dhe 107 në 2021.

KPK-ja ka ndarë të dhënat statistikore të përgjithshme lidhur me Kapitullit XX të KPK-së aktuale mbi “veprat penale kundër integritetit seksual”, përkatësisht nenet 227-236⁴² të KPK-së aktuale, Kapitullit XX të KPK-së (së mëparshëm) përkatësisht nenet 230-243⁴³, dhe Kapitullit XIX të KPPK-së në lidhje me nenet 193-204⁴⁴, pa ofruar statistika të veçanta për rastet e dhunimeve.

42 Kapitulli XX i KPK aktual përfshin krimet në vijim: neni 227 për dhunimin, neni 228 për shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, neni 229 për sulmin seksual, neni 230 për degradimin e integritetit seksual, neni 231 për ofrimin e materialeve pornografike personave nën moshën 16 vjeçare, neni 232 për keqpërdorimin e fëmijëve në pornografi, neni 233 për nxitjen e akteve seksuale me premtim të rremë për martesë, neni 234 për mundësimin ose detyrimin në prostitucion, neni 235 për sigurimin e lokaleve për prostitucion dhe neni 236 për marrëdhëniet seksuale brenda familjes.

43 Kapitulli XX i KPK (i mëparshëm) përfshin krimet në vijim: neni 230 për dhunimin, neni 231 për shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit, neni 232 për sulmin seksual, neni 233 për degradimin e integritetit seksual, neni 234 për abuzimin seksual të personave me çrregullime mendore ose emocionale ose paaftësi, neni 235 për abuzimin seksual të personave nën moshën 16 vjeç, neni 236 për nxitjen e akteve seksuale, prekjën ose aktivitetin nga persona nën moshën 16 vjeç, neni 237 për ofrimin e materialeve pornografike personave nën moshën 16 vjeçare, neni 238 për keqpërdorimin e fëmijëve në pornografi, neni 239 për abuzimin seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin ose profesionin, neni 240 për nxitjen e akteve seksuale me premtim të rremë për martesë, neni 241 për mundësimin ose detyrimin në prostitucion, neni 242 për sigurimin e lokaleve për prostitucion, neni 243 për marrëdhëniet seksuale brenda familjes.

44 Kapitulli XIX i KPPK përfshin krimet në vijim: Neni 193 për dhunimin, neni 194 për kryerjen e akteve seksuale me kërcënim ndaj nderit ose reputacionit, neni 195 për sulmin seksual, neni 196 për degradimin e integritetit seksual, neni 197 për abuzimin seksual të personave me çrregullime mendore ose emocionale ose paaftësi, neni 198 për abuzimin seksual të personave nën moshën 16 vjeçare, neni 199 për nxitjen e akteve seksuale ose prekjën seksuale nga personat nën moshën 16 vjeçare, neni 200 për abuzimin seksual duke keqpërdorur pozitën, autoritetin ose profesionin, neni 201 për mundësimin e prostitucionit, neni 202 për keqpërdorimin e fëmijëve në pornografi, neni 203 për shfaqjen e materialeve pornografike personave nën moshën 16 vjeçare, neni 204 për marrëdhëniet seksuale me njësitë familjare.

Në bazë të këtyre të dhënave statistikore, në vitin 2019, 36% e rasteve janë regjistruar si *“hetime jo të plota në fund të periudhës raportuese”*, ndërsa në vitin 2020 dhe 2021 44% dhe 38% e të gjitha rasteve janë kategorizuar në të njëjtën mënyrë. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së qasjes në të dhënat e zberthyer për veprën penale të dhunimit, ky Mision nuk ka mundur të ofrojë një analizë të saktë në lidhje me kohëzgjatjen e afateve kohore të hetimit me fokus vetëm për rastet e dhunimeve.

KGJK-ja raportoi se 173 raste ishin regjistruar si raste të dhunimit përmes ngritjes së aktakuzave ndërmjet viteve 2019 dhe 2021. Nëntëdhjetë e gjashtë prej këtyre rasteve tashmë ishin në pritje në fillim të vitit 2019, që nënkupton se ndërmjet viteve 2019 dhe 2021 janë ngritur 77 aktakuza të reja (përkatesisht 23 në 2019, 36 në 2020 dhe 18 në 2021). Nga të gjitha këto raste, 76 janë përfunduar në shkallë të parë me aktgjykim ndërmjet viteve 2019 dhe 2021 (konkretisht 48 në 2019, 26 në 2020 dhe 2 në 2021), duke i lënë 97 raste ende në pritje në fund të vitit 2021. Megjithatë, vetëm nga të dhënat statistikore dhe pa qasje në dosjet e rasteve aktuale, nuk ishte e mundur që të vërtetohet nëse aktakuzat e ngritura ndërmjet viteve 2019 dhe 2021 kishin të bënin me krimet të cilat pretendohet se kishin ndodhur në të njëjtën periudhë kohore ose më herët.

Duke i kombinuar të gjitha të dhënat e mësipërme, mund të konstatohet se, edhe pse në PK ishin denoncuar 228 raste nga viti 2019 deri në vitin 2021, janë ngritur vetëm 77 aktakuza të reja kurse vetëm 76 janë përfunduar.

Në të njëjtën kohë, për shkak të mungesës së një sistemi raportimi gjithëpërfshirës dhe të integruar në mes të PK-së, prokurorive dhe gjykatave, ka qenë e vështirë që të sigurohen të dhëna statistikore të konsoliduara për të identifikuar sfidat aktuale në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave. Konkretisht, nuk ishte e mundur të përcaktohej nëse numri i ulët i aktakuzave të ngritura ishte për shkak të vonesave në hetime apo numrit të madh të rasteve të mbyllura pa u ngritur aktakuzë.

4.2.1.2 Vlerësimi i rasteve të përzgjedhura

Për shkak të sfidave të mësipërme lidhur me mungesën e mbledhjes së integruar të dhënave, në shkurt të vitit 2022, EULEX-i ka paraqitur një kërkesë zyrtare në PK për informata shtesë lidhur me hapat hetimorë të ndërmarrë në 228 rastet e identifikuar dhe ka marrë përgjigje në lidhje me 153 raste për periudhën nga gushti 2019 deri në dhjetor 2021. Këto raste janë përmbledhur, renditur gjeografikisht sipas rajoneve dhe janë analizuar. Më pas, ky Mision ju drejtua prokurorive për informacione të mëtejshme për kohëzgjatjen e procedurave për këto 153 raste dhe mori informacion për 129 raste.

Misioni konstatoi se në shumicën e rasteve, kallëzimet penale janë parashtruar nga PK-ja në prokurori brenda një ose disa ditësh pasi kishte ndodhur incidenti ose pas denoncimit të njëjtit në PK.

Në ato raste kur kallëzimet penale janë parashtruar muaj më vonë, PK-ja i ka raportuar arsyet e mëposhtme për këto vonesa:

- Mungesa e identifikimit të dyshuarve;
- Mungesa e provave apo rezultatet e vlerësimit të provave ende mungonin;
- Nevoja për kryerjen e disa hapave para-hetimor për shkak të ndërlikueshmërisë së hetimit.

Misioni konstatoi, gjithashtu, se shkalla mesatare e rasteve të pazgjidhura të cilat janë ende në hetim nga prokuroritë është dukshëm më e lartë në komuna të caktuara. Gjegjësisht, kjo normë është rreth 79% në Prizren, 50% në Mitrovicën e Veriut, 20% në Gjilan dhe 9 % në Mitrovicën Jugore⁴⁵.


⁴⁵ Gjilan : katër nga 20 raste (20%); Gjakovë: dy nga tetë (25%); Mitrovica Jugore: një nga 17 (9%); Mitrovica Veriore: një nga katër (25%); Pejë: dy nga gjashtë (33%); Prishtinë: nëntë nga 43 (21%); Prizren: 15 nga 19 (79%); Ferizaj: pesë nga 15 (33%).

Duke hulumtuar më tej për arsyet themelore për këto vonesa të vërejtura në fazën hetimore, ky Mision mori përgjigje të ndryshme nga prokuroritë, kryesisht që kishin të bënin me të dyshuarit që ndodheshin jashtë Kosovës dhe/ose rasti ishte i kohëve të fundit dhe, rrjedhimisht, hapat hetimor ishin ende në vazhdim e sipër. Megjithatë, në disa raste nuk është dhënë ndonjë arsyetim i caktuar.

Misioni konstatoi se koha mesatare ndërmjet marrjes së kallëzimit penal nga policia dhe ngritjes së aktakuzës nga prokuroria dallon dukshëm në komuna të ndryshme. Koha mesatare është rreth gjashtë muaj e gjysmë në Mitrovicën Jugore, tre muaj e gjysmë në Gjakovë, respektivisht Pejë, dy muaj në Ferizaj, maksimum tre muaj, por në shumicën e rasteve nga një muaj, në Gjilan dhe në dy rastet në Mitrovicën Veriore, një aktakuzë është dorëzuar brenda një muaji dhe tjetra brenda tre muajve. Si për Prizrenin ashtu edhe për Prishtinën, ky Mision nuk kishte marrë të dhëna të mjaftueshme, prandaj nuk ishte në gjendje ta bënte analizën.

Numri i rasteve në të cilat janë ngritur aktakuza është gjithashtu i përcjellë me dallime të konsiderueshme rajonale. Konkretisht, shkalla e aktakuzave të ngritura ishte si vijon: 75% në Mitrovicën Veriore, 70% në Gjilan, 67% në Pejë, 62,5% në Gjakovë, 59% në Mitrovicën Jugore, 47% në Ferizaj, 25,5% në Prishtinë dhe 10% në Prizren⁴⁶. Misioni ka marrë informacione edhe për rastet kur janë shqiptuar masa edukative-korrektuese për të mitur para ngritjes së ndonjë aktakuze.

Për raportin mes numrit të përgjithshëm të rasteve/aktakuzave të ngritura të shpërndara gjeografikisht, shihni diagramin më poshtë:



Bazuar në të dhënat e marra nga KGJK-ja dhe regjistrat e gjykatave themelore, duket se edhe procedurat gjyqësore janë prekur nga vonesat, ku vetëm numër i kufizuar i rasteve janë përfunduar në shkallë të parë. Në vitin 2019 janë finalizuar 40% e të gjitha rasteve të pazgjdhura në periudhën raportuese, në vitin 2020 dhe 2021 vetëm 24,5% respektivisht 7% e rasteve⁴⁷.

⁴⁶ Gjilan: 14 nga 20 (70%); Gjakovë: pesë nga 8 (62,5%); Mitrovica Jugore: 10 nga 17 (59%); Mitrovica Veriore: tre nga 4 (75%); Pejë: katër nga gjashtë (67%); Prishtinë: 11 nga 43 (25,5%); Prizren: dy nga 19 (10,5%); Ferizaj: shtatë nga 15 (47%).

⁴⁷ Bazuar në të dhënat e marra nga KGJK dhe regjistrat e gjykatave themelore, 48 nga të gjitha lëndët e pazgjdhura janë zgjidhur në vitin 2019, 26 lëndë në vitin 2020 dhe dy lëndë në vitin 2021.

Në raste specifike, ndërmjet ngritjes së aktakuzës dhe mbajtjes së seancës fillestarë/shqyrtimit kryesor/nxjerrjes/shpalljes së aktgjykimit, Misioni vërejt vonesa veçanërisht të gjata. Në Gjilan, për shembull, EULEX-i i ka identifikuar tri raste nga viti 2019 me nga 11, 15 respektivisht 20 muaj ndërmjet ngritjes së aktakuzës dhe seancës së parë. Në Ferizaj, Misioni e ka identifikuar një rast tjetër në të cilin gjykimi ka filluar në shkurt të vitit 2020 dhe është ende duke vazhduar.

Në lidhje me aktgjykimet e analizuara nga ky Mision, në rreth 50% të rasteve aktgjykimi ishte shpallur brenda 24 muajve pas kryerjes së veprës. Në raste të tjera, vonesa ishte e gjatë në mënyrë disproporcionale, ky vendimet ishin shpallur më shumë se 14 vjet pas kryerjes së veprës penale. Në dy raste të rigjykuar, aktgjykimet janë shpallur shtatë vjet e gjysmë, përkatësisht nëntë vjet e gjysmë pas aktgjykimeve të para.

Pas interesimit të shprehur tek institucionet përkatëse (prokuroritë dhe gjykatat themelore), për arsytet e këtyre vonesave, ky Mision mori këto arsyetime:

- Mungesa e prokurorëve. Numri i pamjaftueshëm i prokurorëve në Departamentin për të Mitur dhe numri i madh i rasteve me të mitur që kanë sjellë vonesa të mëdha;
- Mungesa e përgjithshme e psikologëve të specializuar që shkaktoi vonesa në intervistimin e viktimave. Sipas nenit 112 të Kodit të Drejtësisë për të Miturit, ekzaminimi i parë dhe i dytë kryhen me ndihmën e psikologut. Më tej, u bë e ditur se nuk ekziston ndonjë sistem në të cilin një psikolog emërohet ose është kompetent për një rajon të caktuar;⁴⁸
- U theksua se institucionet kompetente kishin nevojë për kohë shtesë për mbledhjen e provave, pa e detajuar më tej se çfarë lloj provash apo motivesh e zgjasin marrjen e provave;
- Institucionet u ankuan gjithashtu për mungesën e një protokollit të unifikuar dhe përgjegjësive të përcaktuara qartë midis institucioneve të ndryshme të përfshira, veçanërisht në fazën e marrjes së provave, kryesisht provave mjeko-ligjore. Ato kanë theksuar se ndonëse ekzistojnë procedura specifike për rastet që përfshijnë të mitur sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, si dhe për rastet e dhunës në familje, nuk ekzistojnë udhëzime specifike të unifikuara në fushën e veprave penale seksuale, madje as për rastet ku përfshihen të miturit;
- Vonesat në ekzaminimin e provave të vëzhgimit, gjegjësisht të dhënave telefonike;
- Vonesat në marrjen e rezultateve nga ekzaminimet e provave biologjike. U bë e ditur se raporti i ekzaminimit klinik zakonisht lëshohet menjëherë pas ekzaminimit përkatës, por në raport nuk përfshihen rezultatet e ADN-së apo rezultatet e ekzaminimit të dëshmimeve të tjera mjeko-ligjore, përveç testit të shpejtë të urinës për lëndë narkotike.

4.2.1.3 Konkluzione

Neni 49 i Konventës së Stambollit kërkon që të mos ketë vonesa në fazat e hetimit dhe mbledhjes së provave (veçanërisht në lidhje me mbledhjen dhe testimin e provave mjeko-ligjore) të cilat do ta rrezikonin ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunës kundër grave dhe “...[do të kontribuonin] në mënyrë të konsiderueshme drejt ndjenjës së mosndëshkimit në radhët e kryerësve ..[duke ndihmuar kështu në vazhdimësinë] e niveleve të larta të pranimi të kësaj dhune”⁴⁹. Prandaj,

⁴⁸ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, 06/L-006, 2018: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18019> [qasur më 23 maj 2022].

⁴⁹ Raport shpjegues për Konventën e Stambollit, faqe 43, paragrafi 255.

procedurat e përshpejtuara duhet të përdoren për të gjitha rastet e dhunës kundër grave dhe jo vetëm në kontekste specifike (p.sh. rastet e dhunës në familje). Neni 50 i së njëjtës Konventë i referohet më tej nevojës për t'i intervistuar viktimat pa vonesa.

Jurisprudenca e GJEDNJ-së që rrjedh nga neni 3 i KEDNJ është po aq e rëndësishme. Në rastin *P.M. kundër Bullgarisë*, GJEDNJ e trajtoi çështjen e kohëzgjatjes së hetimeve në një rast të sulmit seksual dhe gjeti një shkelje të nenit 3 në prizmin e kohës së gjatë që u nevojiti për ta përfunduar hetimin. Gjykata konstatoi se *“reagimi i shpejtë i autoriteteve ndaj ankesave është një faktor i rëndësishëm... [si edhe ...] ... çështje të tilla si hapja e hetimeve, vonesat në identifikimin e dëshmitarëve ose marrjen e deklaratave, kohëzgjatja e nevojshme për hetimin fillestar dhe zvarritja e pajustificuar e procedurave penale që rezultojnë në skadimin e afatit të parashkrimit”*⁵⁰.

Ndryshe nga rastet e dhunës në familje të cilat rregullohen me Procedurat Standarde të Operimit dhe udhëzimet⁵¹, Kosovës ende i mungojnë udhëzimet specifike që do të urdhëronin që rastet e dhunimeve të trajtohen me kujdesin dhe urgjencën më të madhe. Ekzistimi i këtyre udhëzimeve të unifikuara jo vetëm që do të përcaktonte detyrime të qarta, por do të ndihmonte edhe në përcaktimin e përgjegjësiive specifike të secilit ofrues shërbimi të përfshirë, duke shmangur kështu vonesat e panevojshme.

Për më tepër, siç u pa më sipër, mungesa e burimeve ka ndikim në zvarritjen e procedurave. Detyrimi i kujdesit të duhur që rrjedh si nga Konventa e Stambollit ashtu edhe nga KEDNJ kërkon që institucionet të ndajnë burimet e duhura njerëzore dhe financiare që mundësojnë zbatimin efektiv të standardeve të kërkuara.

Përveç kësaj, siç është detajuar më sipër, mungesa e grumbullimit sistematik të dhënave për veprat penale të dhunimit në mes të institucioneve të ndryshme në Kosovë e ka penguar mbledhjen efektive të dhënave për kohëzgjatjen e procedurave. Në mënyrë specifike, neni 11 i Konventës së Stambollit e përcakton detyrimin për institucionet që të mbledhin të dhëna përfaqësuese dhe të krahasueshme, në mënyrë që të formësojnë politika për parandalimin dhe luftimin efektiv të gjitha formave të dhunës kundër grave. Siç përshkruhet në hollësi në Raportin Shpjegues të Konventës së Stambollit, *“Parandalimi dhe luftimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje kërkon politikë bërje të bazuar në fakte. Kjo nënkupton dokumentimin efektiv të përmasave të dhunës duke prodhuar të dhëna të forta, krahasuese, në mënyrë që të orientohet politika dhe të monitorohet zbatimi i masave për ta adresuar problemin. [Neni 11 i referohet] detyrimin për ta trajtuar rëndësinë e mbledhjes së rregullt të dhënave përfaqësuese dhe të krahasueshme për hartimin dhe zbatimin e politikave për parandalimin dhe luftimin të gjitha format e dhunës që mbulojnë nga fushëveprimi i kësaj Konvente”*⁵².

Prandaj, është jashtëzakonisht me rëndësi që Kosova ta krijojë një sistem që mundëson dokumentimin efektiv të rasteve të dhunimeve në mënyrë që, mes tjerash, të kuptohet më mirë shtrirja e vonesave në procedura dhe të vendosë masa për adresimin dhe parandalimin e tyre.

50 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *PM kundër Bullgarisë*, nr. 49669/07, 2012, gjendet në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-108781> [qasur më 23 maj 2022].

51 Agjencia Kosovare për Barazi Gjinore, Procedurat standarde të operimit për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë, 2013, gjendet në: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet%20ABGJ/Procedurat%20Standarde%20t%C3%AB%20Veprimet%20p%C3%ABr%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20n%C3%AB%20Familje.pdf> [qasur më 23 maj 2022]; Këshilli Prokurorial i Kosovës, Procedurat standarde të operimit për rritjen e efikasitetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, 2017, gjendet në: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/Procedurat%20Standarde%20te%CC%88%20Veprimet%20pe%CC%88r%20Ngritjen%20e%20Efikasitetit%20ne%CC%88%20Trajtimin%20e%20Rasteve%20te%CC%88%20Dhune%20CC%88ne%8s%88%20Familje.pdf> [qasur më 23 maj 2022].

52 Raport shpjegues për Konventën e Stambollit, faqe 14, paragrafi 74.

4.2.2 Hetimi efektiv dhe përfundimi i rasteve

Shkalla e hetimeve të mbyllura nga prokuroritë⁵³ pa u ngritur asnjë aktakuzë shpërfaq dallime të dukshme nëpër rajone. Në mënyrë specifike, në Ferizaj 20% e rasteve janë mbyllur pa asnjë aktakuzë, në Prishtinë kjo shifër ka arritur në 16%, në Gjilan 10 % dhe në Prizren 5%⁵⁴.

Misioni u interesua për motivet e pushimit. Bazuar në aktivitetet monitoruese të këtij Misioni dhe në përgjigjet e prokurorive, arsyet kryesore për këto pushimet të hetimeve kanë qenë:

- Koha që ka kaluar ndërmjet denoncimit të rastit nga viktimat dhe mundësisë së kryerjes së një kontrolli mjekësor, gjegjësisht mungesa e raportit mjekësor që konsiderohet se e dëmton gjykimin e suksesshëm të rastit;
- Mungesa e lëndimeve fizike dhe/ose raporti i provave biologjike nuk ishte vendimtar për të vërtetuar ndonjë akt të forcës. Në disa nga rastet e analizuara, është vërejtur se rastet janë mbyllur pasi në raportin e ekzaminimit gjinekologjik, të kryer nga IML-ja, thuhet se nuk janë konstatuar lëndime trupore;
- Mungesa e provave të mjaftueshme, madje edhe pas vlerësimit të pajisjeve elektronike dhe llojeve të tjera të provave vërtetuese;
- Deklarata e viktimës nuk ishte e mjaftueshme për ta çuar rastin përpara;
- Viktima e tërhoqi deklaratën ose në disa raste deklarata e viktimës u konsiderua nga prokurori si një akuzë e rreme.

Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit gjatë shtjellimit të nenit 36⁵⁵ i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht aktgjykimit për rastin *M.C. kundër Bullgarisë* ku GJEDNJ-ja ishte *“bindur se çdo qasje e ngurtë ndaj ndjekjes penale të veprave seksuale, si p.sh. kur kërkohet prova e rezistencës fizike në të gjitha rrethanat, rrezikon të lërë të pandëshkuara disa lloje të caktuara dhunimesh dhe kështu e rrezikon mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individit. Në përputhje me standardet dhe tendencat bashkëkohore në atë fushë, detyrimet pozitive të shteteve anëtare sipas neneve 3 dhe 8 të Konventës duhet të shihen si të tilla që kërkojnë penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual pa pëlqim, duke e përfshirë mungesën e rezistencës fizike nga viktimat”*⁵⁶. Për më tepër, GJEDNJ-ja vuri në dukje gjithashtu se: *“Pavarësisht formulimit specifik të zgjedhur nga legjislativi, në një numër vendesh ndjekja penale e akteve seksuale pa pëlqim në të gjitha rrethanat kërkohet në praktikë me anë të interpretimit të kushteve përkatëse ligjore (“shtrëngimi”, “dhuna”, “detyrimi”, “kërcënimi”, “mashtrimi”, “befasia” apo të tjera), si dhe përmes një vlerësimi të ndjeshëm ndaj kontekstit të provave”*⁵⁷.

Neni 36 , paragrafi 2 i Konventës së Stambollit kërkon në mënyrë specifike që ndjekja penale e veprave seksuale të bazohet në një vlerësim të ndjeshëm ndaj kontekstit të provave, në mënyrë që të përcaktohet rast pas rasti nëse viktimat e ka pranuar lirisht ose jo aktin seksual. Prandaj, vlerësimi i nevojshëm duhet të udhëhiqet nga një qasje e bazuar në pëlqim (siç është paraparë edhe me kornizën ligjore në Kosovë), dhe të mos kërkojë dëshmi të përdorimit të dhunës. Për më tepër, *“ky vlerësim duhet ta njohë gamën e gjerë të reagimeve të sjelljes ndaj dhunës seksuale dhe dhunimit që shfaqin viktimat dhe nuk duhet të bazohet në supozimet e sjelljes tipike në situata të tilla. Është po aq e rëndësishme të sigurohet që interpretimet e legjislacionit të dhunimit dhe ndjekja penale e*

53 Misioni e mori këtë informacion vetëm për prokuroritë e specifikuar.

54 Gjilan, dy raste të mbyllura nga 20 (10%); në Prishtinë, shtatë nga 43 (pesë raste të mbyllura me propozime për rritje të mbikëqyrjes ose dërgim në institucionin edukativo-korrektues, dy raste të hudhura poshtë) (16%); në Prizren, një nga 19 (5%); në Ferizaj, tre nga 15 (20%).

55 Raport shpjegues për Konventën e Stambollit , paragrafi 191.

56 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *MC kundër Bullgarisë* , nr. 39272/98, 2003, paragrafi 166, [në tekstin e mëtejshëm *MC kundër Bullgarisë*], gjendet në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-61521> [e qasur më 23 maj 2022].

57 *MC kundër Bullgarisë*, paragrafi 161.

rasteve të dhunimeve të mos ndikohen nga stereotipet gjinore dhe mitet për seksualitetin mashkullor dhe femëror”⁵⁸.

Në të njëjtën linjë, Rekomandimi i Përgjithshëm 33 i CEDAW mbi qasjen e grave në drejtësi i referohet nevojës që shtetet palë të sigurojnë që rregullat për provat të mos jenë kufizuese ose të ndikuara nga stereotipet. Shtetet palë do të “ a)...shfuqizojnë pengesat diskriminuese për qasjen në drejtësi, duke përfshirë: ...*(iii) Rregullat vërtetuese që i diskriminojnë gratë si dëshmitare...duke u kërkuar atyre që të kryejnë një barrë më të lartë të provuarit se burrat për ta vërtetuar një vepër ose për të kërkuar mjet juridik korrigjues; (iv) Procedurat që përjashtojnë ose i japin status inferior dëshmisë së grave; (v) Mungesa e masave për të siguruar kushte të barabarta ndërmjet grave dhe burrave gjatë përgatitjes, zhvillimit dhe pas përfundimit të rasteve; (vi) Menaxhimi joadekuat i rasteve dhe mbledhjes së provave në rastet e paraqitura nga gratë që rezultojnë në dështime sistematike të hetimeve*”⁵⁹.

Po ashtu, neni 49, paragrafi 2 i Konventës së Stambollit kërkon hetim dhe ndjekje penale efektive të veprave. Ai përfshin “*përcaktimin e fakteve përkatëse, intervistimin e të gjithë dëshmitarëve në dispozicion dhe kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore, bazuar në një qasje shumë disiplinore dhe përdorimin e metodologjisë më të fundit për hetime penale për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse të rastit në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së*”⁶⁰. Autoritetet do të përdorin një gamë të gjerë provash jo të viktimitës/vërtetuese të përdorura në rastet e dhunës kundër grave, të cilat për këtë arsye janë të zbatueshme edhe për rastet e dhunimeve. Përkatësisht, “*deklaratat e zyrtarëve të policisë; deklaratat e fqinjëve ose dëshmi të tjera të dëshmitarëve; regjistrimet e thirrjeve të urgjencës/ thirrjeve të policisë; regjistrimet e kamerave mbikëqyrëse/CCTV; fotografitë e lëndimit dhe vendit të ngjarjes; historia/ raportet mjekësore; historia e incidenteve të mëparshme (p.sh. dosja kriminale e kryerësit; urdhrat për përjashtim/mbrojtës nga e kaluara; ndëshkimet administrative); komunikimi nga dhunuesi me viktimën; dëshmi për karakterin e keq të kryerësit dhe dëshmitë e ekspertit, veçanërisht për të shpjeguar ndikimin e dhunës mbi viktimën, sjelljet dhe reagimet e zakonshme të viktimave*”⁶¹.

Misioni po ashtu ka vërejtur se si intervistimet e viktimave në fazën policore shpesh nuk incizohen në mënyrë digjitale dhe nuk merren fjalë për fjalë, por në formë të përmbledhjes. Kjo mund të qoj në rrezikun e pasjes së formës selektive të deklaratës së viktimës me mundësi për lënien jashtë të gjërave, duke kërkuar kështu përdorimin e incizimit digjital të intervistave dhe të teknikave dhe procedurave efektive të intervistimit të ndjeshme ndaj viktimave në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare.

Neni 55, paragrafi 1 i Konventës së Stambollit përcakton më tej se “*Palët do të sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave të përcaktuara në përputhje me nenet [...] 36 [dhunimi], [...] i kësaj Konvente nuk do të varen tërësisht nga një raport ose ankesa e paraqitur nga viktimat [...] se procedurat mund të vazhdojnë edhe nëse viktimat tërhiqet nga deklaratat ose ankesa e saj*”⁶².

Kjo Konventë merr parasysh se veprat si dhunimi kryhen shpeshherë kryhen edhe nga anëtarët e familjes, partnerët intimë ose personat në sferën e afërt shoqërore të viktimës. Kjo mund t'i përkeqësojë më tej ndjenjat e turp, frikës dhe pafuqisë të cilat i vuajnë viktimat si dhe të ndërlidhet me numrin e ulët të denoncimeve dhe, më pas, të bindjeve. Prandaj, institucionet e zbatimit të ligjit dhe prokurorisë duhet t'i hetojnë këto krime në mënyrë pro aktive për të mbledhur prova duke përfshirë prova thelbësore, dëshmi të dëshmitarëve, dhe ekspertiza mjekësore për të mundësuar zhvillimin e procedurave edhe nëse viktimat tërhiqet nga deklaratat ose ankesa e tij/saj.

58 Raport shpjegues për Konventën e Stambollit, paragrafi 192.

59 Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW nr. 33: Qasja e grave në drejtësi, 2015, paragrafi 25, gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_33_7767_E.pdf [qasur më 23 maj 2022].

60 Raport shpjegues për Konventën e Stambollit, paragrafi 256.

61 Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, Qasja e grave në drejtësi: Udhëzues për profesionistët ligjor, tetor 2018, faqe 20, gjendet në: <https://rm.coe.int/factsheet-womens-access-to-justice/16808ff44e> [qasur 24 maj 2022].

62 Konventa e Stambollit, neni 55, paragrafi 1.

Si përfundim, analiza e rastit zbulon se arsyet kryesore për mbylljen e një rasti/pushimin e një hetimi janë tërheqja e deklaratës së viktimës, vlerësimi i deklaratës si jo e besueshme dhe mungesa e provave si lëndimet fizike apo provat biologjike.

Standardet ndërkombëtare kërkojnë që hetimet për rastet e dhunimeve duhet të vazhdojnë pavarësisht tërheqjes së deklaratës nga viktimja, duke e vendosur kështu detyrimin për institucionet hetimore që t'i përmirësojnë standardet për kërkimin e provave të tjera përveç deklaratave të viktimave dhe pavarësisht mungesës së lëndimeve fizike. Korniza ligjore në Kosovë e kriminalizon në mënyrë të saktë veprën penale të dhunimit si vepër të bazuar në pëlqim dhe jo si vepër të bazuar në forcë/shtrëngim. Kjo duhet të pasqyrohet edhe në modalitetet e përdorura nga institucionet përkatëse për trajtimin e rasteve. Gjatë hetimit të një rasti të dhunimit, duhet të shfaqet natyra gjinore dhe diskriminuese e veprës. Më tej, veprimet e ndërmarra nga palët përkatëse institucionale duhet të demonstrojnë një kuptim të natyrës së kësaj forme të dhunës kundër grave, duke përfshirë ndikimin e saj tek viktimat dhe se si mund të ndikojnë kjo në deklaratat e tyre ose gatishmërinë e tyre për të denoncuar dhe për të vazhduar tutje me rastin. Për më tepër, duke kujtuar se marrja e provave, veçanërisht deklaratat e viktimës, gjithmonë duhet t'i përmbahet një qasjeje të bazuar në viktimën dhe të jetë e ndjeshme ndaj aspektit gjinor, vlerësimi i deklaratës së viktimës nuk duhet të bazohet kurrë në supozime ose bindje (për shembull nëse dhuna seksuale është me të vërtetë pa pëlqim, gruaja do të luftojë, prandaj, nëse nuk ka shenja të lëndimeve fizike, atëherë është dhënë pëlqimi).

Në fund, për shkak se natyra e veprës së dhunimit është veçanërisht e vështirë për t'u përcaktuar për shkak të mungesës së shpeshtë të dëshmitarëve dhe ndodhjes së saj në kontekste shumë intime, bazuar në analizën e tij, ky Mision thekson nevojën për të krijuar udhëzime konkrete si dhe trajnime të specializuara për institucionet përkatëse për ta përfutur kuptimin dhe aftësitë e nevojshme për t'i kryer hetimet e duhura.

4.2.3 Ndëshkimi

Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i CEDAW flet për një detyrim për t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore dhe të tjera që janë të nevojshme për t'u ofruar grave mbrojtje efektive kundër dhunës në baza gjinore, duke i përfshirë sanksionet penale⁶³.

Konventa e Stambollit i referohet detyrimit për “*të pasur kujdesin e duhur për të [...] ndëshkuar [...] aktet e dhunës [...]*”⁶⁴. Për më tepër, në Rekomandimin e tij për mbrojtjen e grave nga dhuna, Këshilli i Evropës ka nënvizuar se si duhet të ketë masa dhe sanksione të përshtatshme në legjislacionin vendas, që mundësojnë ndërmarrjen e masave të shpejta dhe efektive kundër kryerësve të dhunës dhe korigjimin e gabimeve të bëra kundër grave që janë viktimat të dhunës⁶⁵.

Në tetor 2021, një vendim gjyqësor për një rast të dhunimit ishte temë e diskutimeve të gjera publike në mbarë Kosovën. Në këtë rast, gjykata e dënoi vetëm me tetë muaj burgim një person të akuzuar për dhunimin e një 15-vjeçareje. Edhe pse neni 227 i KPK-së aktual parasheh dënimin nga pesë deri në 20 vjet burgim në rast se dhunimi kryhet ndaj një personi nën moshën 16 vjeçare⁶⁶, gjyqtari gjeti rrethana lehtësuese, duke përfshirë pranimin e fajësisë dhe moshën e të pandehurit për ta arsyetuar dënimin e ulët të shqiptuar. Këto aktgjykime, përveç neglizhimit të dispozitave të aplikueshme të kodit penal, iu bëjnë me dije kryerësve të veprave se ata mund të ikin prej përgjegjësisë së tyre pa pothuajse asnjë pasojë. Ato

63 Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW), Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW nr. 19: Dhuna kundër grave, 1992, paragrafi 24(t), gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_GEC_3731_E.pdf [qasur më 23 maj 2022].

64 Konventa e Stambollit, Neni 5 – Detyrimet shtetërore dhe kujdesi i duhur.


65 Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2002)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e grave kundër dhunës, 30 prill 2002, paragrafi 35, gjendet në: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?Objec-tID=09000016805e2612 [qasur më 23 maj 2022].

66 KPK aktual, neni 227, paragrafi 6.

po ashtu kanë ndikim negativ mbi gatishmërinë e viktimave që të paraqiten dhe të denoncojnë krime të ngjashme në të ardhmen.

Siç është theksuar tashmë në pjesën për kohëzgjatjen e procedurës, KGJK-ja ka raportuar se 173 raste të dhunimeve kanë arritur në gjykatat themelore në periudhën 2019-2021. Nga këto 173 raste, 76 janë përfunduar dhe në 38 raste janë shpallur aktgjykime dënuese, ndërsa në 38 rastet tjera, gjykatat kanë nxjerrë aktgjykime lirues, refuzues ose lëndët janë parashkruar.

STATUSI I RASTEVE TË DHUNIMIT QË KANË SHKUAR NË GJYKATA MES 2019 DHE 2021



Për të pasur një pasqyrë më të përgjithshme lidhur me arsyetimet e vendimeve të gjykatave, ky Mision ka kryer një analizë të 36 aktgjykimeve duke i përfshirë aktgjykimet që i paraprijnë periudhës 2019-2021. Gjegjësisht, nga këto 36 aktgjykime, 21 raste kanë ndodhur para vitit 2019 kurse 15 të tjerat janë përzgjedhur nga 76 rastet e përfunduara në tre vitet e fundit. Nga analiza e këtyre aktgjykimeve janë nxjerrë gjetjet e mëposhtme:

4.2.3.1 Shkalla dhe arsyet e lirimit nga akuza

Nga 36 raste të analizuara, 16 ishin me aktgjykime liruese (15 lirime nga akuza, një refuzim).⁶⁷ Arsyet e shqiptimit të aktgjykimeve liruese ishin të ndryshme. Ngjashëm me arsyetimet për mbylljen e hetimeve të theksuara më sipër, këto aktgjykime liruese përqendroheshin kryesisht në mungesën e provave të dhunës (duke përfshirë mungesën e lëndimeve në zonën gjenitale të viktimave) dhe pamundësinë e mëvonshme të paraqitur nga gjykatat për të provuar se i pandehuri e ka kryer krimin. Një arsye tjetër lidhej me tërheqjen e deklaratës nga viktima gjatë procesit gjyqësor. Në një rast, viktima deklaroi se kishte gënjer gjatë procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, gjykata ka shqiptuar aktgjykim lirues përkundër faktit se mavijosjet dhe lëndimet trupore ishin të përshkruara në raportin mjekësor. Në një rast tjetër, deklarata e viktimës është konsideruar si jo e besueshme, sepse ndryshonte gjatë çdo faze të procedurës (polici, prokurori, gjykatë). Në aktgjykime të tjera, arsyetimi i gjykatës për shqiptimin të aktgjykimit lirues bazohej në pëlqimin e nënkuptuar të viktimës, duke u bazuar në faktin se personi kishte pasur marrëdhënie të mëparshme me kryesin (kryesit). Ngjashëm, në një rast, gjykata e ka arsyetuar lirimin nga akuza duke u bazuar në faktin se pala e dëmtuar kishte shkuar në vendin e krimit të pretenduar me persona të panjohur. Gjykata konstatoi nga këto veprime se viktima në heshtje ka dhënë pëlqimin për marrëdhënie seksuale.

⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, 2012, neni 364 dhe neni 363 përkatësisht.

4.2.3.2 Dënime të buta

Nga 20 aktgjykime fajësuese, u vu re se 12 ishin nën kohëzgjatjen minimale të dënimit sipas ligjit. Për tetë aktgjykimet tjera, kohëzgjatja e dënimit ishte në përputhje me ligjin.

Pothuajse në të gjitha rastet janë marrë parasysh rrethanat lehtësuese, ndërsa në pak raste janë marrë parasysh rrethanat rënduese. Disa shembuj të rrethanave që gjykatat i vlerësuan si lehtësuese ishin:

- I pandehuri premtoi se nuk do ta shkel më kurrë ligjin;
- I pandehuri i kërkoi falje viktimës;
- Gjendja e dobët ekonomike e të pandehurit; statusi si mbajtës i vetëm në familje ose i papunë;
- Mosha e re e të pandehurit;
- Sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë;
- Pranimi i fajësisë së të pandehurit;
- I pandehuri nuk ka pasur të kaluar kriminale më parë në Kosovë;
- Dallimi i vogël në moshë ndërmjet viktimës dhe të pandehurit;
- I pandehuri kishte familje dhe fëmijë;
- Niveli i ulët arsimor i të pandehurit;
- Gjendja e keqe shëndetësore e të pandehurit;
- Mungesa e lëndimeve fizike të viktimës si pasojë e dhunimit;
- Stërzgjatja e procedurës dhe periudha kohore e kaluar nga ndodhja e krimit (d.m.th. 10 vjet).

Në ato pak raste kur janë zbatuar, janë përdorur rrethanat rënduese të mëposhtme:

- Pesha e veprës penale, mënyra e kryerjes së veprës penale;
- Mosha e vogël e viktimës;
- E kaluara e mëparshme kriminale;
- Kryerja me dashje edhe pse është ditur mosha e viktimës;
- Njohuria për pasojat dhe rrezikshmërinë e krimit;
- Mungesa e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit.

4.2.3.3 Lloji i provave të përdorura

Pothuajse në të gjitha aktgjykimet e analizuara deklarata e viktimës ishte prova kryesore. Shpesh herë viktima është intervistuar tre herë: nga policia, prokuroria dhe gjykata gjatë gjykimit. Deklaratat e mjekëve dhe raportet mjeko-ligjore, aty ku kishte, po ashtu u përdorën si provë. Andaj, në aspekt pozitiv, Misioni vërejti se shkalla e ekzaminimeve mjekësore të kryera dhe të përdora në prova është rritur në mënyrë progresive. Megjithatë, vlerësimi i viktimës nga psikologu është përdorë shumë rrallë si provë. Më tej, vetëm në pak raste prova si kopjet e komunikimit me pajisje teknike dhe raportet nga vendi i ngjarjes (me fotografi) janë prezantuar gjatë gjykimeve përkatëse.

4.2.3.4 Konkluzione

Neni 370, paragrafi 8 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK)⁶⁸, lidhur me aktgjykimet e arsyetuara, thotë se: “Nëse i akuzuari është dënuar me dënim, në arsyetim duhet të tregohen rrethanat që i ka marrë parasysh gjykata në përcaktimin e dënimi. Gjykata, në veçanti, duhet të shpjegojë se nga cilat arsye është udhëhequr nëse ka konstatuar se ishte një rast veçanërisht i rëndë ose është e nevojshme të shqiptohet një dënim më i rëndë se ai që është paraparë, ose nëse ka konstatuar se ka qenë e nevojshme që të ulet dënimi ose të hiqet dorë nga dënimi, ose të shqiptohet një dënim alternativ ose masë e trajtimit të detyrueshëm rehabilitues apo konfiskimin e dobisë pasurore të fituar nga kryerja e veprës penale.” Prandaj, gjykatat ka një detyrim të madh që të arsyetojnë qartë në pjesën e dënimit në aktgjykim arsyet e sakta që kanë çuar deri te dënimi i shqiptuar.

Sa i përket aktgjytimeve të analizuara, është vërejtur një numër i madh i lirimeve apo dënimeve të ulëta.

Njësoj si arsyetimi për mbylljen e hetimeve, shkaqet kryesore për lirim nga akuza kanë qenë mungesa e provës së dhunës/shtrëngimit, tërheqja e deklaratës nga viktimat, vënia në dyshim e besueshmërisë së viktimës dhe shpallja e deklaratës së saj si akuzë e rreme ose e pamjaftueshme për ta provuar rastin përtej dyshimit të arsyeshëm, si dhe supozimet dhe stereotipet mbi pëlqimin e dhënë.

Ky raport rikthen mënyrën se si vepra penale e dhunimit është kriminalizuar në Kosovë si vepër e bazuar në pëlqim, dhe jo si shtrëngim. Për shkak të natyrës së kësaj vepre dhe barrës emocionale që ajo sjell për viktimat, gjykatat duhet të përdorin gjithmonë një qasje të përqendruar te viktimat gjatë zhvillimit të procedurave dhe intervistimit të viktimave. Më tej, gjykatat duhet ta shqyrtojnë me kujdes ndryshimin e deklaratave. Nga viktimat nuk duhet të pritët një barrë më e lartë e provës sesa nga kryerësit. Për më tepër, siç u përmend më sipër, procedurat duhet të kryhen pa u mbështetur në stereotipet gjinore dhe mitet për seksualitetin mashkullor dhe femëror.

Në këtë drejtim, në rastin *Vertido kundër Filipineve*⁶⁹, Komiteti i CEDAW iu referua problemit të stereotipizimit dhe nevojës për t’i adresuar rregullat e provave dhe për të ofruar trajnimin e duhur gjyqësor (veçanërisht në nivelet më të ulëta të gjykatave) për të siguruar që stereotipet dhe mitet e dhunimit të adresohen.

Mitet e dhunimit të trajtuara në rastin *Vertido* kishin të bënin me mundësinë e arratisjes, personalitetin e turpshëm (p.sh. supozimin se personalitetet e forta nuk mund të dhunohen), nevojën për prova të kërcënimit dhe lëndimeve të drejtpërdrejta, çështjen e të kuptuarit të dhunimit brenda kontekstit të dhunimit nga të njohurit, dhe moshës së agresorit. Komiteti vlerësoi se gjykata i bazoi gabimisht gjetjet e saj në mitet dhe stereotipet në baza gjinore për dhunimin dhe viktimat e dhunimit, si dhe deklaroi se nuk duhet të ketë asnjë supozim në ligj apo praktikë që një grua e jep pëlqimin e saj vetëm sepse ajo nuk i reziston fizikisht sjelljes së padëshiruar seksuale. Këto mite shpesh shoqërohen me mite/supozime të tjera të zakonshme për dhunimin, si ato që lidhen me pamjen dhe karakterin e viktimës që ndikojnë në besueshmërinë e saj, si dhe kohën dhe vendin e dhunimit (d.m.th., nëse viktimat ka shkuar në një motel, ai /ajo është dashur ta dinte se çfarë të priste).

Kur merret parasysh numri i madh i aktgjytimeve të buta të nxjerra, në këtë raport u konstatua se si në të gjitha rastet e analizuara, rrethanat rënduese pothuaj nuk janë marrë fare parasysh, ose janë kundërpeshuar plotësisht nga faktorët lehtësues. Më tej, gjykatat nuk kanë ofruar arsyetime të detajuara për këto dënime dhe kanë zgjedhur që t’i referoheshin përfundimit të përgjithshëm se dënimi i shqiptuar ishte i drejtë.

68 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Ligji Nr. 04/L-123, 2012, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocument-Detail.aspx?ActID=2861> [qasur më 24 maj 2022].

69 Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), *Vertido kundër Filipineve*, Komunikimi nr. 18/2008, 2010, gjendet në: <https://juris.ohchr.org/search/details/1700> [qasur më 24 maj 2022].

Neni 69, paragrafi 2 i KPK-së aktuale përcakton se: *“Dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”*.

Neni 70 i KPK-së aktuale i referohet rregullave të përgjithshme për zbutjen ose rëndimin e dënimit. Dënimi i paraparë për forma të ndryshme të dhunimit mund të zbutet maksimalisht deri në gjashtë muaj (nga dy vjet) dhe deri në pesë vjet (nga dhjetë vjet).

Për shkak të natyrës së dhunës kundër grave, neni 45 i Konventës së Stambollit kërkon që veprat të dënohen me ndëshkime efektive, proporcionale dhe bindëse, duke marrë parasysh shkallën e rëndë të tyre⁷⁰. Për më tepër, neni 46 i Konventës përcakton gjithashtu një listë të rrethanave që duhet të merren parasysh si rënduese, për aq sa ato nuk bëjnë pjesë tashmë në elementët përbërës të veprës penale⁷¹.

Vlen gjithashtu të theksohet se Gjykata Supreme e Kosovës, në *“Udhëzuesin për kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Kosovës”*⁷² përmend në mënyrë të veçantë rastet e dhunimeve martesore ku thekson se: *“Është veçanërisht me rëndësi të theksohet se në Kodin e ri [penal] shprehja “marrëdhënie familjare”, e cila nuk është përmendur shprehimisht më parë, është shtuar në nenin 227 (Dhunimi). Në terminologjinë e njohur ndërkombëtarisht, kjo quhet ‘Dhunim bashkëshortor’ që automatikisht e rrit ashpërsinë e dënimit”*⁷³.

Dënimet e ulëta të shqiptuara aktualisht në Kosovë tregojnë se të kuptuarit e veprës së dhunimit, natyra gjinore e saj dhe aspekti i saj diskriminues dhe i shkeljes së të drejtave të njeriut vazhdojnë të jenë sfiduese, ndërsa trajtimi i këtij lloji të rasteve nga institucionet ende shpesh herë ndikohet nga stereotipet dhe supozimet tradicionale.

70 Konventa e Stambollit, neni 45 – Sanksionet dhe masat, paragrafi 1.

71 Konventa e Stambollit, neni 46 për rrethanat rënduese, parasheh si vijon: “...: a) vepra është kryer kundër ish-bashkëshortit apo ish-partnerit apo bashkëshortit apo partnerit aktual, siç njihet nga ligji i brendshëm, nga një anëtar i familjes, një person që bashkëjeton me viktimën ose person që ka abuzuar me autoritetin e saj ose të tij; b) vepra ose veprat e lidhura me to, janë kryer në mënyrë të përsëritur; c) vepra është kryer kundër një personi të cenuar nga rrethana të veçanta; d) vepra është kryer kundër fëmijës apo në prani të fëmijës; e) vepra është kryer nga dy ose më shumë persona që veprojnë së bashku; f) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele ekstreme të dhunës; g) vepra është kryer me përdorimin e armës apo nën kërcënimin e armës; h) vepra ka rezultuar në dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës; i) autori ka qenë i dënuar më parë për vepra të natyrës së ngjashme”.

72 Gjykata Supreme e Kosovës, Udhëzues për kualifikimin ligjor dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit Penal të Kosovës, 2020, gjendet në: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/legalOpinions/75340_Supreme%20Court%20DV%20Guidance_June%202020.pdf [qasur më 24 maj 2022]

73 Po aty, faqe 7.

5. VËREJTJET PËRMBYLLËSE

Përgjatë viteve, po ashtu edhe para përfshirjes së Konventës së Stambollit në Kushtetutën e saj, korniza ligjore e Kosovës në mënyrë progresive është rreshtuar me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për veprat e dhunës seksuale; mos dhënia e pëlqimit nga ana e viktimës tani është elementi përbërës i veprës penale dhe të gjitha llojet e dhunimit të kryer brenda marrëdhënieve familjare bartin ndëshkim më të lartë.

Megjithatë, kriminalizimi adekuat i dhunimit është vetëm hapi i parë; për të siguruar ndjekje penale efektive të kryerësve të veprave, hetimet dhe mbledhja e provave duhet të jenë të shpejta; çdo veprim i kundërt jo vetëm që i rrezikon përpjekjet për të siguruar llogaridhënie, por mund të kontribuojë edhe në krijimin e një kulture të pandëshkueshmërisë dhe ndjenjë të pafuqisë në mesin e viktimave që mund të dekurajohen të ndjekin më tej rrugën e tyre drejt drejtësisë.

Kur të jenë para një raportimi të rastit të dhunimit dhe me qëllim të shmangies së viktimizimit të mëtejshëm, të gjitha autoritetet duhet të veprojnë në mënyrë të bashkërenduar; thënë thjeshtë, ato duhet të dinë saktësisht se çka duhet të bëjnë, kur dhe si. Në këtë drejtim, mungesa e një protokollit specifik, siç janë ato për rastet e dhunës në familje, është zbrazëti që duhet të plotësohet urgjentisht.

Një aspekt i rëndësishëm i ilustruar në këtë raport është mungesa e mbledhjes së sistematizuar të të dhënave nëpër institucionet e ndryshme për veprat e dhunimit. Kjo mungesë në një anë ka penguar marrjen e duhur të informatave nga Misioni, por njëkohësisht ka theksuar rëndësinë e mbledhjes solide të të dhënave të nevojshme për formësimin e politikave.

Ndonëse mostra e aktgjykimeve të shqyrtuara në këtë raport është relativisht e vogël, numri i lartë i lirimeve nga akuza apo i dënimeve të ulëta është shqetësim i rëndë dhe tregues i mungesës së burimeve adekuate njerëzore dhe financiare, mungesës së trajnimeve të specializuara dhe profileve profesionale për personel brenda institucioneve që kanë për detyrë trajtimin e krimeve të tilla, apo i animeve.

Në tërësi, gjetjet e këtij raporti kanë dëshmuar për një numër mangësish në trajtimin e rasteve të dhunimeve në Kosovë, në veçanti në aspektin e kërkesave që dalin nga Konventa e Stambollit dhe CEDAW.

Ky raport ka treguar si kuptimi gjinor i natyrës së veprës penale të dhunimit nga të gjitha institucionet përkatëse, duke e njohur dhunimin si formë e diskriminimit kundër grave dhe vajzave, e që është një prej kërkesave kryesore të Konventës së Stambollit, është shumë i rëndësishëm për të siguruar hetim të shpejtë dhe efektiv, ndjekje penale dhe përfundimisht gjykimin e duhur. Vetëm me këtë qasje mund të sigurohet mbrojtja dhe dëmshpërblimi faktik i viktimave. Një kuptim i tillë duhet të bazohet në një fokus të përqendruar te viktima, e cila do të shmangte ritraumatizimin e viktimave dhe do të largonte pengesat që e përkeqësojnë një ndodhi veçse të vështirë për t'u denoncuar. Kjo qasje gjithashtu do t'i fuqizonte këto viktima gjatë gjithë procedurës. Ndëshkimet dhe dënimet adekuate janë një parakusht, ndërsa shpalljet e pafajësisë dhe dënimet e buta (bazuar në një analizë të rastit pa ndjeshmëri gjinore) janë të dëmshme për ta siguruar dëmshpërblimin për viktimat, fuqizimin dhe gatishmërinë e tyre për të denoncuar, ndërkohë që e nxisin mosndëshkimin e kryerësve. Për t'i zbutur këto mangësi, ky Mision i ka përgatitur, në kapitullin vijues, një sërë rekomandimesh konkrete për PK-në, prokuroritë, gjykatat, Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë.

6. REKOMANDIME

6.1 Për Policinë e Kosovës

- Si vazhdimësi e përmirësimeve të fundit në hetimin dhe denoncimin e rasteve të dhunës në familje, të organizoj dhe të vijoj rregullisht trajnime të specializuara për reagimin ndaj rasteve të dhunimeve, veçanërisht në lidhje me qasjen e përqendruar te viktimat, teknikat e intervistimit të viktimave të dhunimit dhe teknikat e hetimit të rasteve të dhunimit, por pa u kufizuar vetëm në këto;
- Të siguroj të gjitha format e provave vërtetuese që nuk janë të përqendruara në viktimën, pa u kufizuar në provat mjeko-ligjore/biologjike;
- Në këtë drejtim, përdorimi i mjeteve elektronike për incizimin e deklaratave fillestare të viktimave dhe ndonjë dëshmitari duhet të merret parasysh;
- Të ndahen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar mundësinë efektive për t'i përmbushur detyrimet e përcaktuara, duke përfshirë mjetet që mundësojnë ekzaminimin e shpejtë të provave të mbledhura (p.sh. ekzaminimi i të dhënave të telefonit celular);
- Të nxjerr udhëzime të brendshme në të cilat parashihet kujdes maksimal gjatë trajtimit të këtij lloji të rasteve.

6.2 Për prokurorinë

- Të ndahen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar hetime të shpejta dhe pa vonesa, si dhe të siguroj praninë e profileve të specializuara, pra psikologëve mjeko-ligjorë;
- Të organizoj dhe të vijoj rregullisht trajnime të specializuara për reagimin ndaj rasteve të dhunimeve, veçanërisht në lidhje me qasjen e përqendruar te viktimat, teknikat e intervistimit të viktimave të dhunimit, teknikat e hetimit të rasteve të dhunimit, duke e kuptuar natyrën gjinore të krimit, por pa u kufizuar vetëm në këto;
- Të nxjerr udhëzime të brendshme në të cilat parashihet kujdes maksimal gjatë trajtimit të këtij lloji të rasteve.

6.3 Për gjykatat

- Të sigurohet gjykimi i shpejtë dhe me kohë i këtyre rasteve me aktgjykim të duhur, si dhe ndëshkim e dënim efektiv;
- Të ndahen burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar gjykim të shpejtë dhe pa vonesë të këtyre rasteve;
- Të nxirren udhëzime të brendshme që kërkojnë kujdes maksimal gjatë trajtimit të këtij lloji të rasteve.
- Të vijohen rregullisht trajnime të specializuara për gjykimin e rasteve të dhunimeve, veçanërisht trajnime të tilla ku në qendër të vëmendjes është viktimat, vlerësimi i provave, intervistimi i viktimave gjatë procedurës gjyqësore, duke e kuptuar kështu natyrën gjinore të kësaj vepre penale, por pa u kufizuar vetëm në këto;

- Të përmirësohen pasqyrat e zhvilluara së fundmi për gjykatat në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë e proceseve gjyqësore, duke mundësuar identifikimin e trendëve dhe modeleve përkatëse.

6.4 Për Akademinë e Drejtësisë të Kosovës

- Të përgatiten dhe të mbahen trajnime të specializuara për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunimeve, veçanërisht trajnime ku qasja është e përqendruar te viktima, mbledhja dhe vlerësimi i provave, intervistimi i viktimave gjatë procedurave hetimore dhe gjyqësore, duke e kuptuar kështu natyrën gjinore të veprës, por pa u kufizuar vetëm në këto

6.5 Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të udhëheqë zhvillimin e udhëzimeve kombëtare që do ta unifikojnë dhe përmirësojnë trajtimin e rasteve të dhunimeve nga institucionet e ndryshme, ku do të përcaktohen detyrimet, përgjegjësitë dhe procedurat e qarta;
- Të lehtësojë krijimin e një sistemi të integruar të mbledhjes së të dhënave në lidhje me rastet e dhunimeve që do të ndihmonte në analizimin më të mirë të tendencave dhe modeleve, si dhe do të ndihmonte në procedurën përkatëse të politikëbërjes.

